

RAPORTI VJETOR 2020

Instituti i Statistikave

Përmbledhje

Lista e Shkurtimeve.....	3
Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	7
Përmbushja e Detyrimeve të PSZ.....	12
Censet	23
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	26
Cilësia e të Dhënave.....	28
Ngarkesa e të Intervistuarve.....	30
Komunikimi dhe Publikimet.....	36
Strategjitë e Zhvillimit.....	50
Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimi Evropian.....	56
Veprimtaria e Bordit Drejtues.....	63
Veprimtaria e Këshillit të Statistikave.....	64
Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave	66
Baza Ligjore dhe Organigrama	69
Burimet Njerëzore dhe Financiare	74
Përmbushja e Rekomandimeve	82
Kontaktet e Institucionit	88

Ky raport i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, në përputhje me shkronjën (d), pika 2 të nenit 13 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

Lista e Shkurtimeve

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ARN	Anketa e regjistrit të ndërmarrjeve
ANJL	Anketa e njësive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Defiçitit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës i Paraantarësimit në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
KS	Këshilli i Statistikave
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm



Të dashur lexues,

Viti 2020 rezultoi një vit i ngarkuar dhe problematik në aspektin social dhe ekonomik, ndikuar nga pandemia globale Covid-19. Në kushtet e reja të krijuara agjencitë statistikore brenda Sistemit Kombëtar Statistikor, si Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbyllën me sukses aktivitetet statistikore, realizimin e të cilave kam kënaqësinë ta paraqes përpara jush nëpërmjet Raportit Vjetor 2020.

Viti 2020 shënoi një vit plot sfida dhe mundësi të reja për zhvillim, për INSTAT dhe Sistemin Kombëtar Statistikor, si në drejtim të përdoruesve, për ofrimin e të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme, të cilat synojnë të ndihmojnë në gjykimin e tyre mbi përballimin e situatave të vështira, proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale të vendit, por edhe të prodhuesve, në efektivitetin dhe efikasitetin e përshtatjes me metodologji të reja, inovacione, ambiente pune dhe komunikimi për të garantuar vazhdimësinë e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare.

Në përmbushje të misionit të tij, për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, agjencitë statistikore brenda Sistemit Kombëtar të Statistikave realizuan në masën 95,4 përqind kryerjen e aktiviteteve statistikore planifikuara në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2020, nga 131 aktivitete u realizuan 125 prej tyre, në rang Sistemi Kombëtar Statistikor. Ndërkohë që organizoi aktivitete të reja dhe përshtati ato ekzistueset, duke ndihmuar prodhuesit e statistikave dhe përdoruesit të masin dhe studiojnë nëpërmjet shifrave situatën në vend dhe në raport me vendet e rajonit dhe Evropës.

Ky vit u shoqërua me rritje të dokumentimit të aktiviteteve statistikore sipas standardeve ndërkombëtare me afro 17 përqind dhe përmirësim të cilësisë, duke rritur numrin e raporteve të cilësisë me afro 23 përqind.

Publikimet statistikore u shtuan me 2 botime të reja, duke e çuar numrin e tyre në 162 publikime. Besimi i publikut tek INSTAT u rrit me 0,9 përqind, kënaqësia e tyre për aktivitetet statistikore, shërbimin e ofruar u rrit me 0,5 përqind dhe numri i kërkimeve në faqen web të INSTAT për të dhëna statistikore u rrit me 64,2 përqind.

Në kuadër të edukimit statistikor, qëllimi i të cilit është ofrimi i njohurive statistikore për jo-ekspertët e kësaj fushe, INSTAT publikoi për herë të parë gjashtë tema statistikore, për kategorinë nxënës dhe studentë, në një seksion të veçantë në faqen zyrtare të internetit.

Bashkëpunimi me botën akademike, vazhdoi me një përshtatje të re të përmbajtjes së revistës shkencore “Kërkimi”, duke ofruar tashmë dy revista, revistën informative “Infostat” për publikun e gjerë si dhe revistën Shkencore për përdoruesit profesionalë.

INSTAT ka nënshkruar dy memorandume bashkëpunimi me dy institucione të tjera, duke rritur në këtë mënyrë bashkëpunimin me institucionet në vend, në drejtim të rritjes së përdorimit të burimeve administrative për prodhimin e statistikave zyrtare.

Një vlerësim inkurajues u bë për vitin 2020 edhe nga Institucioni Evropian i Statistikave për transmetimin e të dhënave statistikore, për t’i bërë ato pjesë të databazës së madhe të statistikave evropiane dhe të krahasueshme me vendet e tjera, me një rritje prej 116 përqind, krahasuar me vitin 2019.

INSTAT ka forcuar bashkëpunimin me agjencitë e Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet kryerjes së aktiviteteve të përbashkëta, si dy anketave statistikore, vizualizimit të indikatorëve të OZHQ, etj. Ndërkohë, mbështetësi kryesor është Komisioni Evropian, në aktivitete si Censi i Popullsisë dhe Banesave, nënshkrimi i 4 kontratave me fonde në formë granti dhe 20 kontrata shërbimi. Në projektin kombëtar shumëpërfitues, IPA III, INSTAT ka aplikuar me dy komponentë. Zbatimi i këtyre projekteve do të çojë në rritjen e shkallës së përputhshmërisë, përmirësimin e cilësisë dhe harmonizimin e metodologjive me standardet evropiane.

INSTAT për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit të statistikave dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse, në kushtet e situatës së krijuar nga Covid-19, ndërmori veprime të menjëhershme për të siguruar vazhdimësinë e prodhimit të statistikave në kushtet e distancimit social, duke rishikuar prioritetet dhe vendosur objektiva afatshkurtër, duke përditësuar planet e punës sipas kufizimeve dhe kushteve të reja të krijuara, duke shfrytëzuar teknologjinë dhe qasjet inovative, për të siguruar vazhdimësinë e kryerjes së anketave dhe sigurimin e burimeve administrative.

Një risi e krijuar nga kushtet ishte përshtatja e metodave dhe metodologjive, si përdorimi i intervistave telefonike në vend të metodës tradicionale të grumbullimit të informacionit dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ekzistuese apo ndjekja me rigorozitet e rekomandimeve të Eurostat dhe institucioneve ndërkombëtare.

Hartimi i planeve të vazhdimësisë për çdo aktivitet statistikor është një risi nëpërmjet të cilit i jep mundësi këtij institucioni të marrë masa paraprake dhe në kohën e duhur, për përballimin e situatave të ngjashme duke garantuar mosndërprerjen e prodhimit statistikor.

Situata e krijuar kërkonte një mjedis pune të përshtatshëm, si me prezencë dhe me telepunë, për këtë arsye sfida e radhës ishte sigurimi i kushteve për punën online nëpërmjet telepunës, krijimi dhe zbatimi i platformave të reja për komunikimin online ndërmjet stafit, zhvillimi i programeve të reja softuerike për monitorim të situatës shëndetësore të stafit, ndjekje dhe monitorim të detyrave.

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

Për të ardhur sa më pranë përdoruesve, për matjen dhe monitorimin e situatës ekonomike dhe sociale në vend, INSTAT krijoi një seksion dedikuar Covid-19 në faqen zyrtare të tij me publikimet më të fundit dhe më kryesore, si dhe ofroi në mënyrë të përqëndruar të dhëna kyçe socio-ekonomike gjithëpërfshirëse.

Vënia në përdorim e sistemit të aksesit online "SIMONA", si një prej mundësive më të mira për qasje të përdoruesve nga brenda apo jashtë vendit në të dhënat mikro për kërkime shkencore, krijuan lehtësira dhe kushte të favorshme pune.

Bashkëpunime të ngushta me ofruesit e të dhënave dhe partnerët ndërkombëtarë për të mos ndërprerë procesin, për të përballuar me sukses situatën e krijuar edhe në fushën e statistikave u realizuan nëpërmjet rrugëve të reja të komunikimit. INSTAT, edhe pse në kushte distancimi social, nuk ndërpreu punën për zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si në sferën profesionale dhe për menaxhimin e situatës së krijuar.

Në planin origjinal për vitin 2020, sfida kryesore për INSTAT ishte realizimi me sukses i Censit të Popullsisë dhe Banesave, si një prej aktiviteteve më madhore në fushën e statistikave dhe një e mirë publike për vendin. Por, situata në vend dhe mbarë botën e krijuar nga Covid-19, zgjedhjet elektorale 2021 dhe gjetjet e pilotit 2019, ndryshuan sfidën kryesore të këtij institucioni, duke e shtyrë kryerjen e tij në vitin 2022. Në kuadër të punës përgatitore për Censin, përgjatë vitit 2020, INSTAT analizoi rezultatet e Pilotit të Cens, të organizuar në Tetor - Nëntor 2019 në zona të përcaktuara dhe rishikoi strategjinë, planin e aktiviteteve dhe mati impaktin që solli ky proces në koston në tërësi të Cens. Fundi i vitit 2020 u shoqërua me miratimin e ligjit për cens, akt i cili i dha INSTAT autoritetin e plotë të vazhdojë përgatitjet për këtë aktivitet madhor, konform kuadrit të ri ligjor dhe me mbështetjen e strukturave të ngritura për këtë qëllim, në nivel qendror dhe lokal.

Së fundi, nevoja për qasje të reja në zhvillimin e kapaciteteve për të dhëna më të mira, të kuptuarit e ambientit socio-ekonomik nëpërmjet të dhënave dhe statistikave zyrtare, ndërtimi i besimit bazuar në të dhëna dhe statistika, do të na bëjnë të kuptojmë se sa larg kemi arritur.

Së fundi, gjej rastin të falënderoj anëtarët e Këshillit të Statistikës për mbështetjen, Bordin Drejtues të INSTAT për trajtimin me transparencë dhe administrimin e duhur, stafin e INSTAT për përshtatjen e shpejtë, angazhimin, profesionalizmin e treguar gjatë vitit 2020 në arritjen e objektivave të institucionit.

Faleminderit,

Drejtör i Përgjithshëm

Elsa DHULLI

Përmbledhje Ekzekutive

Viti 2020 u karakterizua si vit i sfidave, por edhe i mundësive për statistikën shqiptare. Situata e krijuar nga Covid-19 impaktoi shumë fusha në ekonomi apo jetën sociale, shëndetësore të popullatës. Situata e cila impaktoi institucionet, biznesin, ku nuk u përjashtua edhe Instituti i Statistikave. Për përballjen me sukses të kësaj situatë, si dhe në kushtet e reja të distancimit social, INSTAT përcaktoi objektiva afatshkurtër, në zbatim të misionit të tij dhe parimeve të statistikave evropiane, baza në të cilën mbështetemi për të patur statistika të besueshme, cilësore, në kohë dhe eficiente.

Përballimi me sukses i sfidave forcuan rolin e INSTAT dhe rritën besueshmërinë e tij tek institucionet qeveritare dhe vendore, biznesi, bota akademike, media dhe publiku i gjerë.

Situata e krijuar nga Covid-19 nuk krijoi problematika lidhur me pavarësinë profesionale të këtij institucioni, në respektim edhe të ligjit Nr 17/2018 për Statistikat Zyrtare dhe parimit të parë të statistikave evropiane. Për të ardhur sa më pranë përdoruesit me informacion, INSTAT krijoi një seksion të veçantë në faqen web, dedikuar Covid-19, ku publikoi të dhënat më frekvente, të cilat ndihmuan hartuesit e politikave, analistët, studiuesit, për analiza të mëtejshme ekonomiko-sociale lidhur me situatën e krijuar në vend.

INSTAT, ka mandatin e grumbullimit të të dhënave për prodhimin e statistikave zyrtare nga institucionet, bizneset, familjet. Në zbatim të këtij parimi, INSTAT ka kryer gjatë vitit 2020, 15 anketa pranë ndërmarrjeve, duke anketuar rreth 23,053 ndërmarrje dhe 8 anketa pranë familjeve, duke anketuar rreth 51,302 Njësi Ekonomike Familjare, si dhe ka bashkëpunuar me 30 institucione për sigurimin e informacionit statistikor.

Numri faktik i punonjësve të strukturës së INSTAT në Dhjetor 2020 ka qenë 218 punonjës nga 236 punonjës të planifikuar, me një realizim prej afro 92,4 përqind (206 punonjës në shërbimin civil dhe 12 punonjës administrativë). Gjatë vitit 2020 ishin planifikuar 11 trajnime nga INSTAT, nga të cilët janë organizuar 4 – realizuar plani në masën 36%. Ndërsa numri i të trajnuarve në këto trajnime është 123. Nga SALSTAT janë organizuar 3 trajnime, në të cilët janë trajnuar 136 persona - staf nga institucionet e tjera, si dhe nga ASPA 15 trajnime, ku janë trajnuar 35 persona.

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2020, i miratuar me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar është 758.624 mijë lekë, realizuar në masën 627.069,9 mijë lekë – 82,7%.

Cilësia është një koncept shumëdimensional që prek të gjitha aspektet e funksionimit të institucionit.

Cilësia në statistikën zyrtare përfshin jo vetëm rezultatet statistikore, por edhe proceset statistikore që i prodhojnë ato dhe mjedisin institucional. Sigurimi i cilësisë luan një rol qendror në menaxhimin e INSTAT si

dhe në operacionet e përditshme statistikore. Ky angazhim për cilësinë pasqyrohet edhe në Deklaratën e Cilësisë së INSTAT.

Angazhimi i INSTAT për të rritur cilësinë e statistikave të prodhuara, u konkretizua me publikimin e raporteve të cilësisë për 37 aktivitete statistikore, ku një pjesë e konsiderueshme janë bërë publike edhe në faqen e Eurostat, gjë e cila ndihmon jo vetëm në kuptimin e proceseve statistikore, por edhe në transparencën ndaj publikut për kryerjen e këtyre proceseve.

Fokus i veçantë i është kushtuar forcimit të infrastrukturës statistikore për garantimin e konfidencialitetit të të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet miratimit të rregulloreve dhe udhëzimeve. Një sistem i veçantë, i quajtur “Simona” i është vënë në dispozicion kërkuesve shkencorë për të aksesuar informacionin statistikor në distancë, jo vetëm për arsye të situatës Covid-19, por edhe për t’iu përgjigjur të interesuarve sa më shpejt dhe në formën e duhur. Në grumbullimin e të dhënave stafi ka respektuar parimin e konfidencialitetit dhe ka mbrojtur privatësinë e të dhënave të siguruara nga institucionet, ndërmarrjet apo njësitë ekonomike familjare.

Sistemi Kombëtar Statistikor ka realizuar në mënyrë objektive dhe të pavarur 125 aktivitete statistikore nga 131 aktivitete të planifikuara, duke rezultuar në 6 mosrealizime. INSTAT ka realizuar 113 aktivitete; Banka e Shqipërisë 10 aktivitete dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2 aktivitete. Të dhënat janë bërë publike në të njëjtën kohë për të gjithë përdoruesit, sipas Kalendarit të Publikimeve. Metodologjia e prodhimit të aktiviteteve statistikore dhe përkufizimet, janë konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, sipas modelit të gjeneruar për menaxhimin e proceseve statistikore (GSBPM). Në vitin 2020, janë dokumentuar/përmirësuar sipas këtij modeli 27 aktivitete statistikore. Për zbatimin e këtij standardi janë zhvilluar trajnime edhe pranë dy agjencive të tjera statistikore. Në kuadër të kufizimeve të krijuara nga pandemia globale, INSTAT ndoqi të gjithë rekomandimet e vëna në dispozicion nga Eurostat, lidhur me prodhimin e statistikave zyrtare, nga procesi i dizenjimit deri tek përgatitja dhe publikimi i të dhënave.

INSTAT mirëmban regjistrin statistikor të ndërmarrjeve ekonomike, jo-bujqësore, të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, si një nga shtyllat kryesore të prodhimit të statistikave ekonomike, konform standardeve evropiane. Për të qenë të krahasueshëm me statistikën e vendeve të tjera, INSTAT dhe Agjencitë Statistikore përdorin klasifikimet standarde ndërkombëtare dhe Evropiane si; Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike; Klasifikimi i Profesioneve; Klasifikimi i Produkteve; Klasifikimi i Arsimit; Klasifikimi i Shëndetësisë; etj.

Për të kuptuar nëse parimet e cilësisë statistikore janë zbatuar në aktivitetet statistikore të ndërmarra në nivel sistemi, INSTAT ka filluar prej vitit 2019 procesin e vlerësimit statistikor nëpërmjet auditit statistikor dhe vetëvlerësimit. Gjatë vitit 2020, është kryer auditimi për Anketën e Forcave të Punës si dhe është

iniciuar auditi për 2 aktivitete të tjera si Anketa e Buxhetit të Familjes dhe Anketa Vjetore pranë Ndërmarrjeve.

Edhe pse në kushte pandemie, matja e ngarkesës së të intervistuarve ishte një nga sfidat kryesore edhe gjatë vitit 2020. Sipas të dhënave të monitorimit, janë anketuar rreth 14,2 përqind e ndërmarrjeve nga 162.342 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2019. Nga 20.370 ndërmarrje, 97,4 përqind e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak se pesë anketa, ndërsa 2,6 përqind e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se pesë anketa. Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta, për anketat pranë ndërmarrjeve, ishte 38,5 minuta.

Përsa i takon familjeve, janë anketuar rreth 7,1 përqind Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Cens 2011. Ku 29 përqind e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se dy anketa. Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta për anketat pranë familjeve ishte 33,9 minuta.

Përdorimi i burimeve administrative, si burime kryesore për zëvendësimin e anketave statistikore me qëllim uljen e kostos dhe rritjen e efektivitetit, kërkon angazhimin jo vetëm të INSTAT, por edhe të institucioneve, zotëruese të të dhënave administrative. Për të kuptuar drejt koston e çdo aktiviteti statistikor, si element i dosmosdoshëm për planifikimin e drejtë të tyre, është e nevojshme matja e tij me anë të sistemeve përkatëse. Në vitin 2020, nëpërmjet Sistemit të Përdorimit të Kohës (SIPK) dhe vlerësimit të burimeve financiare të përdorura, janë kostuar 65 aktivitete statistikore.

Prodhimi i statistikave ka për qëllim rritjen e besimit dhe kënaqësisë tek përdoruesit. Në vitin 2020, kënaqësia e përdoruesve u rrit 0,5 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë niveli i besimit në statistika u rrit me 0,9 pikë përqindje dhe niveli i kënaqësisë me faqen e internetit të INSTAT, ku përdoruesit mund të konsultohen lehtësisht me statistikën, u rrit me 0,7 pikë përqindje.

Në interes të forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe përpunimit të fushës statistikore, INSTAT nënshkroi memorandume bashkëpunimi me Avokatin e Popullit dhe Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Informacionit.

INSTAT në procesin e prodhimit statistikor ndjek kriteret shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave. Zbatimi i saktë i këtyre elementeve ka bërë që Politika e Trajtimit të Gabimeve të statistikave të publikuara të mos përdoret në asnjë aktivitet statistikor.

Numri i publikimeve statistikore të INSTAT shkoi në 162 publikime nga 160 të realizuar në vitin 2019, përfshi këtu publikime statistikore dhe libra. Vetëm për 2 publikime nuk u respektua afati sipas përcaktimeve në kalendar, për shkak të situatës pandemike të krijuar në vend.

Në kuadër të procesit të Integritetit, Komisioni Evropian ka përcaktuar Kapitullin 18 “Statistikat”, si një prej kapitujve themeltar për hapjen e negociatave, gjë që reflekton rëndësinë e statistikave zyrtare të

prodhuara sipas standardeve evropiane me qëllim që raportet e mëtejshme të progresit e monitorimit të bazohen në shifra sa më të sakta e profesionale.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar indikatorëve në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm, ku INSTAT ka prodhuar dhe publikuar 7 indikatorë të rinj, duke e rritur numrin në 49 indikatorë statistikorë.

Objekti i shpërndarjes dhe publikimit të INSTAT është të promovojë përdorimin maksimal të informacionit statistikor të prodhuar. INSTAT ka siguruar që statistikave të prodhuara të paraqiten në mënyrë të qartë, pavarësisht nëse ato shpërndahen në format letër apo në internet. Publikimet zyrtare statistikore janë përgatitur për të lehtësuar kuptimin e të dhënave dhe për të shmangur keqinterpretimin. Seksioni "Dokumentimi" në faqen zyrtare të internetit të INSTAT, është përditësuar me informacion mbi cilësinë dhe metadat në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare. Shërbimet e shpërndarjes përdorin teknologji moderne të informacionit dhe komunikimit.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikave zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore janë udhëhequr nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të përafuara edhe nga legjislacioni shqiptar në vitin 2018.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë e përdoruesve në to. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe shtrihet në të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane. Parimet e statistikave zyrtare që përmban ky kod janë të përafuara edhe në ligjin për statistikave zyrtare, përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij. Synimi i përafrimit të këtyre standardeve mundëson zbatimin e duhur të PSZ-së, nëpërmjet përmirësimit të proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave zyrtare dhe rritjen e imazhit në publik drejt besueshmërisë në statistikave zyrtare. Parimet e statistikave zyrtare, rezultatet sipas të cilave u përmendën më lart, janë si në vijim:

a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;

b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kritereve shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;

c) **"pavarësia profesionale"**, që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, të cilit nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloji grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;

ç) **"përkatësia"**, që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) **"kosto-efektiviteti"**, që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) **"konfidencialiteti statistikor"**, që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) **"transparenca"**, që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Indikatorët e performancës

Korniza për vlerësimin e performancës institucionale ka për qëllim të kontribuojë në ndjekjen, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e efikasitetit të veprimtarive që kryen institucioni. INSTAT e ka ndërtuar këtë kornizë duke identifikuar indikatorët e duhur që lidhen me aspektet kryesore strategjike dhe menaxheriale të tij, përfshirë edhe standardizimin e proceseve statistikore, të cilat rrisin cilësinë e aktivitetit statistikor. Gjithashtu, në kornizë janë përfshirë edhe indikatorë të cilët lidhen me përmbushjen e kërkesave të përdoruesve brenda dhe jashtë vendit për aktivitetet statistikore koherente dhe cilësore. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe krahasueshmëria me vendet e tjera në rajon dhe Evropë.

INSTAT për të matur performancën e punës së tij, në drejtim të realizimit të aktiviteteve statistikore, ka identifikuar, monitoruar dhe raportuar 13 tregues për vitin 2020. Në tabelën në vijim janë paraqitur indikatorët e vlerësimit të performancës për vitin referencë.

Tabela 1: Indikatorët e performancës për vitin 2020 dhe niveli i arritjes

Indikatorët PAF	2018		2019		2020		Trendi
	(Në vlerë absolute)	(Në %)	(Në vlerë absolute)	(Në %)	(Në vlerë absolute)	(Në %)	
Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	48	85,7 %	60	25 %	70	16,7 %	↗
Numri i raporteve të cilësisë	20	30 %	30	42,90 %	37	23,3 %	↗
Indeksi i Nivelit të përgjithshëm të kënaqësisë së përdoruesve	3,73	15,8 pikë %	3,85	1,1 pikë %	3,87	0,5 pikë %	↗
Numri i anketave pranë familjeve	10		14		8		↘
Numri i NJEF të intervistuar	59.702		81.870		51.302		↘
Numri i v anketave pranë ndërmarrjeve	16		16		15		↘
Numri i ndërmarrjeve të intervistuar	21.752		20.370		23.503		↗
Kohëzgjatja e anketës për anketat pranë familjeve	40,47		29,61		38,5		↗
Kohëzgjatja e anketës për anketat pranë ndërmarrjeve	37,87		37,68		33,9		↘
Numri i vlerësimeve statistikore të kryera	0		2		2		-
Numri i publikimeve	159		160		162		↗
Numri i publikimeve të reja	12	4,3 %	9	2,5 %	2		↘
Publikime në kohë		82,10 %		78,5 %		95,3 %	↗
Numri i aktiviteteve statistikore që kanë përmirësim në afat	27		9		1		↘
Data points në Eurostat data base për Shqipërinë	1.580.153	56 %	1.382.072	-12,5 %	2.989.437	116 %	↗
Numri i vizitave në website	1.341.928	10 %	2.001.281	49,13 %	3,285,976	64,19 %	↗

Përmbushja e Detyrimeve të PSZ

Zbatimi i Planit Vjetor 2020 të PSZ

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë, i cili përcakton objektivat strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe aktivitetet prioritare statistikore për tu përmbushur nga sistemi gjatë harkut kohor prej pesë viteve. Programi hartohet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe pasi diskutohet në Këshillin e Statistikave dhe me grupet e interesit, i përcillet Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Mbështetur në ligjin e ri për statistikën zyrtare, zbatimi i Programit sigurohet nëpërmjet një Plani Vjetor, dokument i cili miratohet gjithashtu nga Kuvendi. Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021.

Për vitin 2020, në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 ishin parashikuar 131 aktivitete statistikore për tu realizuar, nga të cilat 119 mbulohen nga INSTAT, 10 nga Banka e Shqipërisë dhe 2 mbulohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë realizuar aktivitetet e planifikuara për vitin, ndërsa INSTAT ka kryer 113 aktivitete statistikore, ndërsa 6 aktivitete të tjera nuk u finalizuan për shkak të situatës së krijuar nga Covid19.

Gjatë vitit 2020, INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Programit. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative janë kryer aktivitetet statistikore kryesisht:

Në fushën “*Statistikat Sociale dhe Demografike*” janë realizuar temat statistikore si: Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj; Puna dhe kostot e punës; Arsimi; Mbrojtja sociale; Drejtësia dhe krimi si dhe Kultura. Nuk është përfunduar tema mbi Shëndetësinë, pasi nuk janë publikuar të dhënat e Shëndetit Publik dhe tema mbi Të Ardhurat dhe Konsumin, temë e cila përfshin 4 aktivitete statistikore, nga të cilat janë realizuar 3 aktivitete statistikore dhe nuk është përfunduar 1 aktivitet statistikor, pasi nuk janë publikuar rezultatet nga Anketa e Nivelit të Jetesës për vitin 2019.

Në fushën “*Statistikat Ekonomike*” janë realizuar plotësisht temat statistikore: Statistikat makroekonomike; Statistikat financiare të Qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe Statistikat e ndërmarrjeve.

Për fushën “*Statistikat Sektoriale*” janë realizuar temat statistikore si: Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi; Energjia; Transporti; Turizmi; Tregtia e jashtme; Bilanci i Pagesave; dhe nuk është përfunduar tema mbi Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin si dhe tema mbi Çmimet. Tema mbi Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin përfshin 18 aktivitete, nga të cilat 16 janë realizuar dhe 2 nuk janë përfunduar, pasi nuk janë publikuar të dhënat e TIK në familje për vitin 2020, si dhe nuk është realizuar aktiviteti për Statistikat mbi Kërkimin Shkencor vetëm për sektorët e institucioneve publike dhe të arsimit të lartë; Tema mbi Çmimet përfshin 4

aktivitete, ku nga të cilat janë realizuar 3 aktivitete statistikore, ndërsa aktiviteti mbi Çmimet e Banesave nuk është realizuar.

Përsa i përket fushës së “Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain”, për temën e Statistikave të Mjedisit, nga 7 aktivitete të planifikuara, 6 aktivitete janë realizuar plotësisht, ndërsa aktiviteti i statistikave të cilësisë së ajrit është realizuar pjesërisht. Lidhur me temën e Informacionit Statistikor Rajonal dhe Gjeohapësinor, është kryer Miratimi i Standardeve shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri për temën “Demografia” dhe “Njësitë Statistikore”, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i Njësive Statistikore 2020 (zonave të censit - ZC) në zona specifike: Objekte të identifikuara "në ndërtim" gjatë përditësimit të vitit 2019 dhe përditësim në "Zonat e prekura nga fatkeqësia natyrore (tërmet 26.11.2019)".

Informacioni në vijim paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet kryesore të realizuara sipas fushave përkatëse statistikore.

Fusha e Statistikave Sociale dhe Demografike

Gjatë vitit 2020, INSTAT ka prodhuar tregues mbi popullsinë, tregues mbi të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesve; tregues gjinorë; tregues të punësimit dhe papunësisë; treguesit kryesorë të konsumit të Njësive ekonomike familjare (NjEF); tregues mbi nivelin e jetesës; tregues të arsimit; tregues të shëndetësisë; mbrojtjes sociale; tregues të krimeve dhe tregues të kulturës. Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj fushe janë kryer anketa mbi: Buxhetin e Familjes, të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës, Forcat e Punës, si dhe mbi Strukturën e të Ardhurave nga Puna.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2020:

- Statistikat e Popullsisë;
- Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar;
- Statistikat Vitale;
- Aktivitetet mbështetëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave;
 - a) Miratimi i Ligjit të Censit;
 - b) Përgatitja e raportit mbi gjetjet e Censit Pilot 2019;
 - c) Përpunimi i Pyetësorit të Censit;
 - d) Përditësimi i aplikacioneve për grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin për Censin;
 - e) Editimi dhe kontrollet e cilësisë në gjeodatabazë.
- Statistikat e azilit dhe të huajve;
- Statistikat gjinore;
- Statistikat nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës;
- Statistikat nga të dhënat administrative të Tregut të Punës;
- Statistikat nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna;
- Statistikat nga të dhënat administrative mbi pagat;

- Statistika të regjistrimeve në arsim;
- Statistika të diplomimeve në arsim;
- Statistika të shpenzimeve të buxhetit të shtetit mbi arsimin publik;
- Statistika mbi shkaqet e vdekjeve;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga Anketa e të Ardhurave dhe Matjes së Nivelit të Jetesës 2020;
- Statistika nga Anketa e Buxhetit të Familjes;
- Statistika nga të dhënat administrative mbi mbrojtjen sociale;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave sociale për sistemin ESSPROS;
- Statistika mbi veprat penale dhe autorë; procedimet penale dhe të pandehurit; të burgosurit;
- Statistika mbi të dënuarit;
- Statistika mbi kulturën.

Aktivitetet statistikore të realizuara gjatë vitit të raportimit, por të paparashikuara në Program:

- Vdekjet javore;
- Anketa e Migracionit në Familje, 2019;
- Anketa SILC+;
- Anketa Covid-19;
- Anketa e Dëmtimeve të Familjeve nga Tërmeti;
- Indeksi i privimit të fëmijëve;
- Indeksi i barazisë gjinore;
- Aktivitete statistikore lidhur me Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për qëllime Statistikore;
- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017:
- Anketa e Nivelit të Jetesës-EU SILC;
- Anketa Evropiane e Shëndetit.

Aktivitete statistikore të papërfunduara gjatë vitit 2020:

- Statistikat mbi Shëndetin Publik

Statistikat mbi Shëndetin Publik për vitin 2019 nuk u publikuan për shkak të marrjes me vonesë të të dhënave administrative nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga Instituti i Shëndetit Publik.

- Statistikat nga Anketa e Nivelit të Jetesës 2019

Publikimi i të dhënave të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019 nuk u realizua për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 dhe pamundësia e përdorimit të paketave të SAS (nga Eurostat) gjatë telefonës.

Aktivitete të reja statistikore për vitin 2021

- Përgatitja e materialeve të nevojshme për kryerjen e Cens (pyetsori, manuale, materiale trajnimi);

- Kryerja e fazës Pilot II për Cens 2022;
- Kryerja e testeve për Anketën post Cens.
- Zhvillimi i Anketës së Kostos së Punës;
- Përpunimi dhe publikimi i rezultateve të Anketës Evropiane të Shëndetit;
- Llogaritja e Indeksit të Privimit Material të Fëmijëve, 2019 në bashkëpunim me UNICEF.
- Përshtatja e Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP) 2018:
- Përgatitje për Anketën e Përdorimit të Kohës (TUS):

Fusha e Statistikave Ekonomike

Në fushën e statistikave ekonomike, agjencitë brenda Sistemit Kombëtar Statistikor gjatë vitit 2020 ka prodhuar treguesit e llogarive kombëtare në frekuencë vjetore dhe tre-mujore, tregues strukturorë dhe afatshkurtër për ndërmarrjet; statistika monetare dhe financiare, të borxhit etj. Për prodhimin cilësorë të treguesve të kësaj fushe janë kryer: Anketa mbi statistikën strukturore të ndërmarrjeve, Anketa mbi listën e mallrave industrialë pranë ndërmarrjeve ekonomike, Anketa mbi çmimet e produkteve industriale dhe ndërtimit.

Në vijim, aktivitetet statistikore të realizuara gjatë vitit 2020:

- Statistika mbi Llogaritë Vjetore sipas sektorëve institucionalë;
- Statistika vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit;
- Statistika vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve;
- Statistika tremujore të Produktit të Brendshëm Bruto me metodën e Prodhimit dhe Shpenzimeve;
- Statistika mbi tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output;
- Statistika mbi Llogaritë Rajonale;
- Metodologjia për Llogaritë Financiare;
- Statistika mbi Llogaritë Financiare;
- Statistika mbi Bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; depozitat dhe kreditë;
- Statistikat mbi Normat e interesit të aplikuara për sasitë e reja dhe sasitë gjendje;
- Statistika mbi Bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera financiare;
- Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë;
- Statistikat mbi borxhin e sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhin e garantuar;
- Statistika nga anketa vjetore për listën e mallrave industrialë pranë ndërmarrjeve ekonomike;
- Statistika strukturore të ndërmarrjeve;
- Statistika strukturore në nivel rajonal;
- Statistika afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike;
- Statistika nga anketa tremujore e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike;

- Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Regjistri statistikor i ndërmarrjeve;
- Regjistri i njësive lokale ekonomike.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparashikuara në Program:

- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017:
 - Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Procedura e Deficitit të Tejkualuar;
 - Metodologjia e Llogarive Kombëtare;
 - Programi i Transmetimit ESA 2010;
 - Llogaritë Rajonale;
 - Sektorët Institucionalë;
 - Tabelat Burim-Përdorime dhe Input-Output;
 - Treguesit e disbalancës makroekonomike;
 - Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve;
 - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve;
 - Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve.

Aktivitete të reja statistikore për vitin 2021:

- Përmirësime të mëtejshme të Llogarive Kombëtare, në kuadër të projekteve statistikore të IPA 2017:
 - Metodologjia e Llogarive Kombëtare;
 - Transmetimi i llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore;
 - Përmirësime të Llogarive jo-financiare sipas sektorëve institucional;
 - Llogaritë sektoriale;
 - Tabelat burime-përdorime dhe input-output;
 - Treguesit e Imbalancës Makroekonomike;
 - Llogaritë rajonale;
 - Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Procedura e Deficitit të Tejkualuar;
- Finalizimi i Projektit SECO për GFS dhe EDP-në;
- Vlerësimi i treguesve të Administratës Publike sipas nën-sektorëve - Sektori Publik në Shqipëri;
- Vlerësimi i taksave me çmime korrente bazuar në Listën Kombëtare të Taksave (NTL);
- Vlerësimi i subvencioneve me çmime korrente mbështetur në pëmirësimet e projektit statistikor “Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Procedura e Deficitit të Tejkualuar”;
- Përmirësim në mënyrën e grumbullimit të të dhënave (Web Form, CAPI ,CATI);
- Prodhimi i statistikave mujore të tregtisë me pakicë, për përdorim të brendshëm;

- Mbulimi më i mirë i aktiviteteve në fushën e shërbimeve në statistikat afatshkurtra dhe studimi i mundësisë së llogaritjes së tyre duke përdorur burime administrative;
- Revizionimi i kampionit të ASN, duke shtrirë mbulimin në nivel 3 dhe 4 shifror sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike. Transmetim i treguesve shtesë të ASN/ATN në Eurostat.

Fusha e Statistikave Sektoriale

Në fushën e statistikave sektoriale janë prodhuar tregues të bujqësisë, energjisë, transportit, turizmit, tregtisë së jashtme, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Për prodhimin cilësor të këtyre treguesve janë kryer:

- Anketa vjetore në bujqësi;
- Anketa mbi sipërfaqen e mbjellë;
- Anketa mujore mbi thertoret për gjedhë, derra dhe të imta;
- Anketa mujore mbi thertoret e shpendëve;
- Anketa mujore në pularitë për prodhimin e vezëve;
- Anketa vjetore mbi qumështin;
- Anketa mujore mbi qumështin e Lopës;
- Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore;
- Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim;
- Anketa mujore e turizmit në strukturat akomoduese;
- Anketa e turizmit në familje;
- Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje dhe familje.

Në vijim, aktivitetet statistikore të realizuara gjatë vitit 2020:

- Statistikat mbi pyjet dhe biodiversitetin;
- Statistikat nga anketa vjetore në bujqësi;
- Statistikat mbi produktet bimore;
- Statistikat nga anketa mbi sipërfaqen e mbjellë;
- Statistikat mbi blegtorinë, mishin dhe vezët;
- Statistika nga anketa mujore mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta;
- Statistika nga anketa mujore mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve;
- Statistika nga anketa mujore në pularitë për prodhimin e vezëve;
- Statistika nga anketa vjetore mbi grumbullimin dhe përpunimin e qumështit;
- Statistika nga anketa mujore mbi grumbullimin dhe përpunimin e qumështit të lopës;
- Statistika mbi qumështin dhe nënproduktet e tij;
- Statistika vjetore mbi llogaritë ekonomike në bujqësi;

- Statistika tremujore mbi llogaritë ekonomike në bujqësi;
- Statistika nga anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore;
- Statistika nga anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim;
- Statistika vjetore mbi peshkimin;
- Statistika tremujore mbi peshkimin;
- Statistika mbi akuakulturën;
- Statistika mbi prodhimet organike në bujqësi;
- Statistika mbi agromjedisin;
- Statistika të bilancit tremujor të energjisë elektrike;
- Statistika të bilancit të përgjithshëm të energjisë;
- Statistika mbi transportin ajror, detar, ujqor të brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve;
- Statistika mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor;
- Statistika mbi aksidentet;
- Statistika mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë;
- Statistika nga anketa mujor në strukturat akomoduese;
- Statistika nga anketa e turizmit në familje "Pushime dhe Udhëtime";
- Botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri";
- Statistika mbi investimet direkte mjete dhe detyrime;
- Statistika mbi tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve;
- Statistika mbi eksportet/importet e mallrave;
- Statistika mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve;
- Statistika të bilancit tremujor të pagesave;
- Statistika të bilancit mujor të pagesave;
- Statistika mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare;
- Statistika për indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK);
- Statistika për indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (IHÇK);
- Statistika të matjes së fuqisë blerëse (MFB);
- Anketa vjetore e inovacionit pranë ndërmarrjeve ekonomike;
- Statistikat e inovacionit 2017-2019;
- Anketa vjetore mbi "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" në ndërmarrje, 2020;
- Statistikat e TIK në ndërmarrje për vitin 2019;
- Pilotimi i sistemit të informacionit për aksesin në mikrodata nëpërmjet Internetit;
- Dokumentimi i proceseve ekzistuese të sigurimit të konfidencialitetit statistikor;
- Trasferimi në Eurostat i metadatës në përputhje me standardin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor;

- Publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadatave sipas fushave të prodhimit statistikor;
- Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi në lidhje me rëndësinë e metadatave për agjencitë e tjera statistikore;
- Harmonizimi i proceseve të statistikore në drejtim të GSBPM, në bashkëpunim me NSI-të e tjera, aty ku është e mundur;
- Zhvillimi i trajnimeve të statistikienëve për aplikimin e standardit GSBPM;
- Përfshirja e disa pyetjeve dedikuar matjes së treguesve të cilësisë, të cilat duhet të përfshihen në anketat ekzistuese apo të reja që do të implementojë INSTAT;
- Matja e kënaqësisë së përdoruesve;
- Matja e kënaqësisë së punonjësve të INSTAT;
- Pyetësori i vetëvlerësimit për 2 aktivitete statistikore;
- Audit statistikor për 1 aktivitet statistikor;
- Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i teknologjisë në nivel hardware dhe software në mbledhjen e të dhënave, duke ruajtur konfidencialitetin dhe privatësinë;
- Përmirësimi i rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe dokumentimi i plotë i procedurave.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparashikuara në Planin Vjetor të PSZ:

- Prodhimi i të dhënave mbi rasantet e peshkut sipas specieve
- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017:
 - Statistikat e kërkim-zhvillimit dhe buxhetit të shtetit të alokuar për kërkim-zhvillimin;
 - Statistikat e bujqësisë;
 - Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit dhe çmimet e banesave;
 - Statistikat e matjes së fuqisë blerëse;
 - Menaxhimi i cilësisë;
 - Zbatimi i standardeve për metadatat dhe shkëmbimin e të dhënave.

Aktivitete të papërfunduara gjatë vitit 2020:

- Statistika nga anketa mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në njësitë ekonomike familjare (NjEF), 2020;
- Kryerja në terren e anketës mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në njësitë ekonomike familjare (NjEF), 2020, për arsye të pandemisë u shty si proces, i cili solli si pasojë shtyrjen e proceseve në vazhdim. Statistika mbi kërkimin shkencor vetëm për sektorët e institucioneve publike dhe të arsimit të lartë;

- Statistika mbi kërkimin shkencor vetëm për sektorët e institucioneve publike dhe të arsimit të lartë nuk është realizuar, pasi për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, nuk u realizua kryerja në kohë e disa hapave të projektit pilot PP 3.9;
- Statistikat e kërkim-zhvillimit dhe të fondeve të buxhetit të shtetit për aktivitetin e kërkim-zhvillimit, (GBARD)", pjesë e të cilit ishte edhe mbledhja e të dhënave për këto dy sektorë;
- Statistikat mbi çmimet e banesave nuk është realizuar aktiviteti mbi statistikën e çmimeve të banesave për shkak të mungesës së informacionit shtesë nga burimet administrative.

Aktivitete të reja statistikore për vitin 2021;

- Publikimi i dedikuar për statistikën e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit;
- Llogaritja dhe transmetimi në Eurostat i të dhënave statistikore rajonale për numrin e krerëve të blegtorisë në nivelin NUTS 2;
- Hartimi i dokumentave strategjik në kuadër të Cens të Bujqësisë;
- Tregues të rinj mbi karakteristikën e mjeteve të transportit rrugor;
- Transmetimi i të dhënave të TIK në Eurostat;
- Anketa mbi aktivitetin e kërkim-zhvillimit në institucionet publike, institucionet e arsimit të lartë, ndërmarrjet private dhe organizatat private jo-fitimprurëse, 2018-2020;
- Publikimi i të dhënave kryesore për treguesit e kërkim-zhvillimit për katër sektorët.

Fusha e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain

Ndër treguesit kryesorë të kësaj fushe, të prodhuar gjatë vitit 2020, mund të përmendim treguesit mbi llogaritë fizike dhe monetare në mjedis, treguesit e ujit, tregues të zhurmave, tregues mbi mbetjet, ku për prodhimin cilësorë të këtyre të fundit është kryer anketë mbi mbetjet e ngurta urbane. Ndërsa për temën e Informacionit statistikor rajonal dhe gjeohapësinor janë miratuar standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri për temën "Demografia" si dhe janë përditësuar vazhdimisht njësitë statistikore (zonat e Censit).

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2020:

- Statistika mbi llogaritë monetare në mjedis;
- Statistika mbi llogaritë fizike në mjedis;
- Statistika mbi mbetjet;
- Statistika nga anketa vjetore mbi mbetjet e ngurta urbane;
- Statistika mbi mbetjet industriale;
- Statistika mbi ujën;
- Statistika mbi zhurmat;

- Miratimi i standardeve shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri për temën “Demografia” dhe “ Njësiti Statistikore”.
- Përditësimi i vazhdueshëm i njësive statistikore (zonave të censit - ZC):
 - Objekte të identifikuar "në ndërtim" gjatë përditësimit të mëparshëm;
 - Përditësim në " Zonat e prekura nga fatkeqësia natyrore (tërmet 26.11.2019)".

Aktivitete të parealizuara gjatë vitit 2020:

- Statistikat mbi Cilësinë e ajrit

Statistikat mbi cilësinë e ajrit u realizuan pjesërisht për shkak të paplotëshmërisë së informacionit të marrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Aktivitete të reja mbështetëse të SKS – jo-statistikore për 2021:

- Përgatitja e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026;
- Konsultimi me institucionet që janë burim informacioni për rishikimin e treguesve në kuadër të hartimit të PSZ 2022-2026;
- Konsolidimi i metodave për mbledhjen e të dhënave on-line;
- Forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për shkëmbimin e informacionit;
- Finalizimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me për zhvillimin e statistikave të krimeve;
- Ndjekja dhe raportimet periodike për strategjitë si:
 - Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare;
 - Strategjia Kombëtare e Migracionit;
 - Agjenda Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
 - Strategjia për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve;
 - Strategjia e Barazisë Gjinore.
- Përgatitja e artikujve të rinj shkencorë/informativ për revistën Kërkimi/Infostat;
- Përgatitje e moduleve të reja të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve për stafin e INSTAT.

Censet

Censi i Popullsisë dhe Banesave

Aktivitetet e Censit ndahen në tre faza kryesore:

1. Faza përgatitore ose para-numërimit
2. Faza e numërimit
3. Faza e pas-numërimit

Në muajin Dhjetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe të Banesave”, si dokumenti kryesor i cili do të mundësojë kryerjen e censit në përputhje me standardet profesionale dhe shoqërore si dhe ngritjen e instrumenteve mbështetëse të veprimtarisë. Aktualisht, projekti është në fazën e para-numërimit. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2020 u analizuan gjetjet e pilotit të kryer në 2019, për të vlerësuar përmirësimet e mëtejshme të të gjitha fazave të Censit. Raporti mbi gjetjet e Censit Pilot 2019 do të shërbejë për përmirësimin e materialeve, si dhe marrjen e vendimeve të rëndësishme për ecurinë e punës përgatitore si dhe sigurimin e një procesi të suksesshëm të Cens 2022. Është rishikuar buxheti, strategjia, plani i aktiviteteve dhe regjistri i riskut. Gjithashtu, është rishikuar pyetësi nga stafi i INSTAT dhe ekspertët ndërkombëtarë, si dhe janë përcaktuar objektivat, metodologjia, planifikimi dhe rezultatet e Anketës Pas Censit (APC). Gjatë këtij viti është formuar një ekip i APC-së me specialistë nga njësitë e metodologjisë, Teknologjisë së Informacionit, Gjeoinformacionit dhe logjistikës.

Gjatë vitit 2020, në aspektin Gjeohapësinor, janë kryer kontrollet e cilësisë së të dhënave të ardhura nga terreni dhe përditësimin e gjeodatabazës, përfshirë edhe përditësimin në terren në disa zona specifike. Gjatë muajve Nëntor-Dhjetor, janë përditësuar hartat e Censit për zonat e papërfunduara në vitin 2019, si rezultat i tërmetit të 26 Nëntorit, si dhe për disa zona specifike të zgjedhura nga njësia gjeohapësinore, kryesisht ndërtesa të cilat u identifikuan në statusin “ndërtesa në ndërtim”. Bazuar në gjetjet e pilotit, u vlerësua platforma që do të përdoret në Cens. Gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2020 ka filluar puna për zhvillimin e aplikacionit të mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave.

Aktivitetet e planifikuara në 2021

Viti 2021 rezervon një sërë aktiviteteve përgatitore të Censit. Pas miratimit të ligjit Nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe të Banesave”, do të ngrihet Komisioni Qendror i Censit dhe Komisionet e Censit në nivel Bashkie si dhe do të hartohet Plan Vjetor për vitin 2022, pjesë integrale e të cilit do të jetë Data e Censit dhe Pyetësi i Censit.

Me qëllim kryesor testimin e metodologjisë, pyetësit, manualeve si edhe aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin, do të organizohen 3 teste paraprake, si edhe do të kryhet një tjetër pilot i Censit, ku do të testohen të gjitha fazat e tij. Gjithashtu, do të realizohet edhe piloti për APC.

Komunikimi në lidhje me Censin është thelbësor për të siguruar pjesëmarrjen e popullatës procesin e regjistrimit. Komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës mbi rëndësinë e censit, do të fokusohet tek fushata informuese përpara Pilotit II të Censit, si dhe do të zhvillohen takime me palët e interesuara (ministritë e linjës, bashkitë, donatorët, etj.)

Aktivitetet gjeohapësinore luajnë një rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e Cens. Gjatë 2021, do të vazhdojë puna për fazën e para-numërimit si: kontrollet e cilësisë së ndërtesave dhe banesave të përditësuara në terren gjatë 2020; përditësimi i kufijve të zonave të regjistrimit sipas numrit të banesave të identifikuar gjatë përditësimit të hartës në terren në 2019; përditësimi i zonave specifike në terren të censit (ZC), kryesisht në zona urbane. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, njësia e Gjeoinformacionit do të kontribuojë në përgatitjen e informacionit gjeohapësinor, (ndarja e kufijve të ZC-së, kodifikimi i të gjithë informacionit gjeohapësinor, përgatitja e hartave dixhitale për tu aksesuar në aplikacionin e pyetësorëve të censit, etj.) për të mbështetur aktivitetet e testeve, pilotit të dytë të Cens si dhe APC.

Logjistika, përveç angazhimit që do të ketë për të realizuar me sukses dhe në kohë pilotin, do të synojë që të vërë në zbatim dhe monitorojë sa më shumë të jetë e mundur të gjitha procedurat që parashikohen të zhvillohen në Cens (përgatitje materiale, organizim trajnimesh, shpërndarje dhe grumbullim materiale, etj.). Një element i rëndësishëm tek i cili do të punohet gjatë vitit 2021 do të jetë edhe vlerësimi i situatës në terren. Kjo parashikon që të zhvillohen takime me pushtetin vendor për të identifikuar sa më saktë mundësitë dhe elementët që do të mund të suportohen nga këto struktura, por njëkohësisht edhe për të mbledhur informacion dhe vlerësuar nevojat për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta suportojnë Cens-in sipas kërkesave të tij.

Teknologjia e informacionit përbën një element të rëndësishëm në procesin e Cens, jo vetëm në kuadër të automatizimit të proceseve, por sidomos për faktin që të dhënat do të mblidhen me pyetësorë elektronikë. Gjatë vitit 2021 do të vazhdohet puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Cens. Do të zhvillohen dhe testohen sistemet e Teknologjisë së Informacionit për pyetësorin elektronik, si edhe sistemin e monitorimit të procesit në terren. Një hap i rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës është edhe trajnimi i përdoruesve të këtyre sistemeve. Piloti i dytë do të jetë një test i rëndësishëm në lidhje me aplikacionet e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave, pasi është një moment kyç për testimin e sistemeve në tërësi.

Gjatë këtij viti do të fillojnë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve IT të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të Censit.

Censi i Bujqësisë

Censi i ardhshëm i Bujqësisë ishte planifikuar të kryhej në vendin tonë në vitin 2022, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Censin e Bujqësisë 2020 .

Kryerja e Censit të Bujqësisë është e lidhur ngushtë me rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave, pasi me të dhënat e përfituara nga moduli i bujqësisë në pyetësor, mundësohet ndërtimi i një bazë të re zgjedhjeje për Censin e Bujqësisë.

Faza përgatitore për Censin e Bujqësisë ndikohet në terma kohorë dhe logjistik nga Censi i Popullsisë dhe Banesave, i cili do të zhvillohet në Tetor 2022. Mbi këto baza, INSTAT, në mënyrë që të angazhohet plotësisht për të gjitha aspektet teknike dhe operacionale, është i detyruar të shtyjë Censin e Bujqësisë në vitin 2024. INSTAT, gjatë vitit 2020, në bashkëpunim me ekspertizën ndërkombëtare, ka rishikuar modulin e pyetjeve të cilat janë përfshirë në pyetësorin e Censit të ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave, me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore. Lista e përditësuar e fermave do të jetë korniza për Censin e ardhshëm të njësive ekonomike bujqësore.

Në punën përgatitore që INSTAT ka zhvilluar gjatë vitit 2020 përfshihet edhe përpjekja për gjetjet e burimeve të mundshme financiare mbështetëse për "Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Censin e Bujqësisë". Hartimi i strategjisë do të shërbejë për të planifikuar dhe detajuar elementët më të rëndësishëm të projektit, si dhe për përgatitjen e kuadrit rregullator dhe vlerësimin e burimeve dhe aktorëve që do të përfshihen më tej. Kjo përpjekje u finalizua në fund të vitit 2020, me një marrëveshje me FAO për mbështetjen në hartimin e dokumentave strategjikë për Censin e Bujqësisë.

Bazuar në përcaktimin e qartë të vizionit dhe objektivave strategjikë për kryerjen e censit, si dhe në planin përkatës të veprimeve sa më të detajuara, do të jetë e mundur edhe tërheqja e fondeve nga donatorët, të cilët kanë mbështetur vazhdimisht veprimtarinë statistikore në vend.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në kuadër të zbatimit të Agjendës 2030, për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, INSTAT ka përgatitur botimin e tretë me indikatorë statistikorë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, punë që ka filluar që prej vitit 2019, me botimin e parë të treguesve statistikorë si dhe me platformën për OZHQ-të, mbështetur nga UNDP, e cila përditësohet vazhdimisht dhe gjendet në faqen zyrtare të INSTAT <http://instat.gov.al/al/sdgs/>.

INSTAT vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë OZHQ-ve, pasi statistikën janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikën dhe strategjinë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për një vendimmarrje të bazuar në evidenca.

Botimi i vitit 2020 përmban 42 indikatorë, 14 indikatorëve më shumë krahasuar me botimin e vitit 2018, i cili përmbante 28 indikatorë. Gjatë vitit 2020, nga një bashkëpunim me UNICEF u prodhuan dhe 7 indikatorë të rinj, të cilët e çuan numrin total në 49 indikatorë. Indikatorët e rinj janë pjesë e një botimi të veçantë dedikuar fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri.

INSTAT ka përfshirë në Planin Vjetor 2021 për zbatimin e PSZ 2017-2021, prodhimin dhe monitorimin e OZHQ-ve, bazuar në burimet ekzistuese, anketa statistikore apo burime administrative.

Për rritjen e numrit të indikatorëve dhe standardizimit të metodologjive të prodhimit të tyre INSTAT bashkëpunon me institucionet e tjera në vend. Një nga këto institucione është Avokati i Popullit, i cili ndihmon në prodhimin e indikatorëve të objektivit 16 "Paqe drejtësi dhe institucione të forta". Për shkëmbimin e informacionit, mbledhjen zyrtare të të dhënave, shpërndarjen, analizën dhe sigurimin e informacionit për grupet vulnerabël është nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me këtë institucion.

Gjatë periudhës në vazhdim do të përgatitet fletëpalosje për informimin e përdoruesve mbi rëndësinë dhe situatën aktuale të OZHQ në vend.

INSTAT është angazhuar në një bashkëpunim me Komisionin Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE), nëpërmjet mbështetjes së zyrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, dhe gjatë muajve Janar - Mars 2021, do të zbatojë një projekt për përf forcimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave, në mbështetje të proceseve vendimmarrëse të bazuara në fakte, në kuadër të Covid-19 në Shqipëri si dhe për impaktin e Covid-19 mbi OZHQ-të në vendet e Ballkanit perëndimor dhe specifikisht në Shqipëri. INSTAT, gjithashtu, do të vijojë kontributin e tij në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtim të Kapaciteteve për Statistikat për Axiendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm - HLG PCCB, ku Shqipëria është anëtare që prej muajit Nëntor të vitit 2019. Prej muajit Nëntor, 2020, Znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT, është emëruar bashkëkryetare e Grupit të

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Nivelit të Lartë të Partneritetit, Koordinimit dhe Ndërtimit të Kapaciteteve për Statistikat për Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (HLG-PCCB), ku kontribuon vazhdimisht në mbledhjet periodike të këtij grupi.

Cilësia e të Dhënave

INSTAT synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. INSTAT është angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e statistikave. Në përputhje me Ligjin e Statistikave, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikatat të jenë sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

Gjatë vitit 2020, në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Në përputhje me parimin 4 “Cilësia Statistikore” të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT ka ndërmarrë disa iniciativa si: dokumentimi i proceseve statistikore sipas modelit të përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM, matja e kostos së aktiviteteve statistikore si edhe implementimi i Auditit Statistikor. Në përputhje me parimin 9 “Ngarkesa ndaj të intervistuarve”, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës. Në përputhje me parimin nr. 10 “Kosto dhe Efektiviteti”, të Kodit të Praktikave Evropiane, si edhe në përmbushje të rekomandimit nr. 19 të Peer Review, për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore dhe duhet të përdorë informacionin që rezulton për qëllime menaxhimi duke përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit, INSTAT ka ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore.

INSTAT gjatë vitit 2021 do të punojë në kuadër të përmirësimit të cilësisë statistikore. Puna do të fokusohet në hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara, INSTAT gjatë vitit 2021 do të trajnojë stafin e INSTAT dhe të agjencive statistikore, në lidhje me adaptimin e modelit të përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM (Generic Statistics Business Process Model) version 5.1, të implementuar në shumë shtete të Evropës dhe më tej.

Me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikatat zyrtare, në kuadrin e cilësisë statistikore, për vitin 2021, parashikohet të publikohen 40 raporte të cilësisë, të kryhen 2 Vetëvlerësime dhe 1 Audit statistikor. Gjithashtu, INSTAT planifikon 1 audit statistikor dhe për 2 aktivitete statistikore të plotësohet pyetësi i vetëvlerësimit. Në fund të procesit të auditimit statistikor do të vlerësohen situatat problematike dhe do të sugjerohet gjetja e rrugëve për përmirësimin e tyre.

Dokumentimi i proceseve statistikore

INSTAT, për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara për tu kryer gjatë vitit 2020, zbatoi modelin e përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM (Generic Statistics Business Process Model), të implementuar në shumë shtete të Evropës dhe më tej. Në vetvete, ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar.

Në vitin 2020, INSTAT ka punuar për përditësimin në version më të ri të modelit GSBPM në versionin 5.1. Ky version thekson gjithnjë e më shumë rëndësinë e procesit të integritetit të të dhënave statistikore në të gjitha të dhënat në dispozicion.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë dokumentuar për herë të parë ose përditësuar 27 aktivitete statistikore të cilat ndjekin këtë model. Për sistemin kombëtar statistikor u organizua një workshop me temën “Cilësia, Raportet e Cilësisë/Metadatat dhe përdorimi i GSBPM”.

Auditi Statistikor

Mbështetur në pikën 3 të nenit 17 të ligjit për Statistikat Zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditimi statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo aktiviteti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Hapat e implementuara, me synimin kryesor rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore për vitin 2020, ishin ndjekja dhe plotësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit për 2 aktivitete statistikore, si edhe hartimi i raportit të auditit statistikor për Anketën e Forcave të Punës.

Raportet e Cilësisë

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e aktiviteteve statistikore, ku në vitin 2020 janë publikuar 37 raporte në faqen e web-it, me një rritje prej rreth 23,3%, krahasuar me vitin 2019. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format dhe standardet që INSTAT përdor në metodat dhe përkufizimet e aplikuara si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e aktiviteteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuarve për t'ju përgjigjur pyetësorëve të INSTAT në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Në vitin 2020 në 15 anketa pranë ndërmarrjeve janë anketuar rreth 23.053 ndërmarrje. Ndërsa në 8 anketa pranë familjeve janë anketuar rreth 51.302 Njësi Ekonomike Familjare.

Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (Response burden): numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2020 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2020, duke marrë në konsideratë gjithë anketat pranë ndërmarrjeve ekonomike që INSTAT realizon.

Tabela 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësor	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	137.810	14.415	174	1.027
10_19 të punësuar	501	2.890	474	268
20_49 të punësuar	488	1.225	834	252
50+ të punësuar	490	292	508	694

Në vitin 2020, janë anketuar rreth 14,2% e ndërmarrjeve nga 162.342 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2019. Janë intervistuar të paktën një herë gjatë vitit 20.370 ndërmarrje, nga të cilat 97,4% e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak se 5 anketa, ndërsa 2,6% e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 anketa pranë ndërmarrjeve të realizuar nga INSTAT gjatë vitit 2020.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2016-2020, duke marrë në konsideratë të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve ekonomike që INSTAT realizon.

Tabela 3: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve


Numri i ndërmarrjeve	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Intervistuar të paktën një herë	23.053	20.370	21.752	24.025	20.615
0 Pyetësor	139.289	142.257	140.700	136.748	131.613
Gjithsej	162.342	162.627	162.452	160.773	152.228

Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2020, INSTAT ka realizuar 15 anketa pranë ndërmarrjeve, ndër të cilët 4 janë anketa të reja me frekuencë vjetore.

Tabela 4: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësor	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	89,8%	9,4%	0,1%	0,7%
10_19 të punësuar	12,1%	69,9%	11,5%	6,5%
20_49 të punësuar	17,4%	43,8%	29,8%	9,0%
50+ të punësuar	24,7%	14,7%	25,6%	35,0%

Figura 1: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes



Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 89,8% nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 9,4% kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe 0,8% e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar 91,0% e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për tu përgjigjur dhe vetëm 9,0% e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart, ku rreth 75,3% e tyre duhet t’i përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Anketat pranë familjeve

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2020 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2020 janë anketuar rreth 7,1% Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej

51.302 NJEF, nga të cilat 71,0% (36.438) e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një anketë, ndërsa 29,0% e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë anketa pranë familjeve të realizuar nga INSTAT gjatë vitit 2020. Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të anketave sipas qarqeve për vitin 2020, duke marrë në konsideratë të gjithë anketat pranë familjeve që INSTAT realizon.

Tabela 5: Shpërndarja e numrit të anketave sipas qarqeve

Qarku	Asnjë anketë	Një anketë	Dy e më shumë anketa	Numri i NJEF për Qark
Berat	35.685	1.994	814	38.493
Dibër	27.408	1.479	686	29.573
Durrës	61.691	3.500	1.459	66.650
Elbasan	67.727	3.782	1.535	73.044
Fier	75.964	4.399	1.711	82.074
Gjirokastrë	19.478	1.230	579	21.287
Korçë	55.653	3.214	1.304	60.171
Kukës	15.651	975	500	17.126
Lezhë	29.785	1.646	805	32.236
Shkodër	50.289	2.842	1.298	54.429
Tiranë	184.231	8.945	3.042	196.218
Vlorë	47.398	2.432	1.131	50.961
Gjithsej	67.0960	36.438	14.864	722.262

Gjatë vitit 2020, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 11.987 NJEF ose 6,11% e tyre në total. Rreth 93,89% e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë anketë, 4,56% e tyre kanë marrë pjesë në 1 anketë dhe vetëm 1,55% e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë anketa të realizuara nga INSTAT.


Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2016-2020, duke marrë në konsideratë të gjithë anketat pranë njësive ekonomike familjare, që INSTAT realizon.

Tabela 6: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve

Numri i NJEF	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016
Intervistuar të paktën një herë	51,302	81,870	59,702	46,940	40,804
0 pyetësor	670,960	640,392	662,560	675,322	681,458
Gjithsej	722,262	722,262	722,262	722,262	722,262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2020, INSTAT ka realizuar 8 anketa pranë familjeve, ndër të cilat 1 është anketë e re me frekuencë vjetore.

Figura 2: Ngarkesa e përgjigjes për NjEF që janë përzgjedhur për t'u intervistuar gjatë vitit 2020




Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrative. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përta i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta

Në lidhje me indikatorin e dytë kohëzgjatjen mesatare të intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2020, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.

Figura 3: Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta/ Pyetësorë



Kohëzgjatja e intervistës për anketat pranë familjes është mesatarisht rreth 33,9 minuta, krahasuar me 29,6 minuta që ishte në vitin 2019. Minutazhi i intervistës është rritur si pasojë e ruajtjes së distancës fizike, si një nga kushtet e mbrojtjes nga Covid-19. Ndërsa për anketat pranë ndërmarrjeve kohëzgjatja e intervistës është 38,5 minuta, krahasuar me 37,7 minuta që ishte në vitin 2019. Ulja e minutazhit të intervistës ka ardhur nga përdorimi i të dhënave administrative. INSTAT për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarve punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimin e anketuesve.

Raporti kosto-efektivitet

Për të siguruar cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, prodhuesit e statistikave zyrtare duhet të marrin masa për matjen e raportit kosto-efektivitet. Ky raport nënkupton se kostot e prodhimit statistikor duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultateve dhe përfitimeve të kërkuara, se burimet duhet të jenë përdorur në mënyrë optimale dhe barra e përgjigjes të jetë minimale.

Në 2018-ën u vendos në funksion sistemi i përdorimit të kohës, SIPK, i cili ka për qëllim matjen efektive të kostos së aktiviteteve statistikore. Edhe ky sistem bazohet në fazat dhe proceset kryesore të modelit GSBPM.

INSTAT gjatë vitit 2020 ka krijuar një metodologji gjithëpërfshirëse që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore. Kostimi i aktiviteteve statistikore është realizuar për 65 aktivitete.

Planet e vazhdimësisë së Aktiviteteve Statistikore


Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 gjatë vitit 2020 pati një ndikim të rëndësishëm si në aspektet e jetës ashtu edhe në mbarëvajtjen e punës në institucion. Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia, INSTAT u përqendrua maksimalisht për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e aktiviteteve statistikore.

Në kuadër të menaxhimit të veprimtarisë me risqet e shtuara nga pandemia, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së prodhimit statistikor, për të përmbushur misionin kryesor të institucionit, INSTAT gjatë vitit 2020 punoi në lidhje me përcaktimin e formatit të planit të vazhdimësisë. Bazuar në formatin e aprovuar u përgatitën Planet e Vazhdimësisë për 72 Aktivitete Statistikore.

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, aty ku është e mundur, në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Në Tetor të vitit 2020, INSTAT zhvilloi raundin e katërt të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT në vitin 2020 është rritur me 0,5 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2020 ka pësuar gjithashtu rritje kënaqësia me faqen e internetit të INSTAT me 0,7 pikë përqindje dhe indikatorin e besimit se INSTAT ka të dhëna të besueshme me 0,9 pikë përqindje. Grafiku i mëposhtëm përshkruan krahasimin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve përgjatë viteve 2017-2020.

Figura 4: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT sipas viteve 2017-2020



Komunikimi dhe Publikimet

Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer një sërë aktivitete për t'iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.


Duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në rëndësinë e statistikave zyrtare, INSTAT ka ndërtuar një strategji të veçantë drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve. Për më tepër, gjatë vitit 2020, INSTAT ka lançuar projektin “Edukimi statistikor”, i cili prezanton modulet hyrëse në statistika për studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme. Gjithashtu, gjatë këtij viti, INSTAT ka publikuar numrin e 4-të të revistës shkencore “Kërkimi” dhe numrin e parë të revistës informative “Infostat”.

Viti 2020 shënoi një rritje të vizibilitetit të INSTAT në publik. Më poshtë paraqiten disa tregues të rritjes së vizibilitetit të INSTAT dhe rritjes së performancës së Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve, gjatë vitit 2020:

- **Publikimet:** Gjatë vitit 2020, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 162, nga 160 që ishte në vitin 2019. Në vitin 2021 janë parashikuar të publikohen 163 publikime.
- **Kërkesat e përdoruesve:** Sa i takon kërkesave të përdoruesve, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për herë të parë në vitin 2009, numri i kërkesave të përdoruesve për të dhëna statistikore ka ardhur në rritje. Në vitin 2020, numri i kërkesave të përdoruesve është 861. Kjo vlerë është ulur me 57 kërkesa, krahasuar me vitin 2019, ku numri i kërkesave ishte 918.
- **Rrjeti social facebook:** Gjatë vitit 2020, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.899 nga 5.705 në 2019.
- **Vizibiliteti në media:** Gjatë muajve Janar-Dhjetor 2020, përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 2.500 herë (gjatë vitit 2019 numri i përmendjeve ishte 2.870 herë) në përmbajtjen e 1.321 artikujve të botuar në shtypin shqiptar. Ndërkohë, në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 59 përmendje. Në edicionet kryesore të lajmeve të 9 Televizioneve kryesore shqiptare, përmendja dhe citimi i INSTAT është vërejtur gjithsej 744 herë në përmbajtjen e 428 kronikave në lajmet kryesore. Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 16.512 herë në përmbajtjen e 8.160 artikujve (në 2019 kjo vlerë ishte 7.516).
- **Statistikat e website:** Për vitin 2020 faqja web e INSTAT ka pasur 3.285.976 page views¹, me një rritje prej 1.284.695 shikimesh ose 64,19%, krahasuar me vitin 2019, ku kjo vlerë ishte 2.001.281.

¹ Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

Figura 5: Gjatë vitit 2020, janë publikuar 162 publikime



Botime të reja

- Strukturat akomoduese (Publikimi tremujor)
- Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020 (Libër)

Librat

- Vjetari Statistikor Rajonal, 2020
- Tregtia e Jashtme e Mallrave dhe Ndërmarrjet, 2020
- Burra dhe Gra në Shqipëri, 2020
- Tregu i Punës, 2019
- Regjistri i Ndërmarrjeve, 2019
- Ndërmarrjet e Huaja dhe të Përbashkëta, 2017-2019
- Turizmi në Shifra, 2019
- Shqipëria në Shifra, 2019
- Diaspora e Shqipërisë në Shifra, 2019
- Sustainable Development Goals – SDG
- Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, 2016-2018
- Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna (ASAP) 2018



Vjetari Statistikor Rajonal 2020

Vjetari Statistikor Rajonal 2020 është një botim i përbërë prej 200 faqesh, i ndarë në 19 kapituj, me një kapitull përmbledhës për secilin qark dhe 19 kapituj tematikë, socialë dhe ekonomikë. Risia e këtij botimi është pasurimi me tregues të rinj në nivel bashkie me 2 seksione të reja. Kapitulli “Struktura administrative dhe njësitë territoriale të Shqipërisë”, ka një seksion të ri të titulluar “Shqipëria në rajon (Jo vendet e BE-së)” dhe “Mjedisi”, një kapitull krejtësisht i ri.



Diaspora e Shqipërisë në Shifra

Ky publikim kryhet nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Diasporës. Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. Për të arritur në statistika edhe më gjithëpërfshirëse, INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere të vendeve pritëse të diasporës shqiptare.

INSTAT

Regjistri i ndërmarrjeve




Publikimi “Regjistri i ndërmarrjeve, 2019” përmban të dhëna të detajuara për njësitë ekonomike që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Treguesit në këtë botim bazohen në regjistrin statistikor të ndërmarrjeve të vitit 2019, i cili përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike të të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.B).

INSTAT

Shqipëria në Shifra



Publikimi “Shqipëria në Shifra, 2019” paraqet në mënyrë sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Disa nga kapitujt janë: Popullsia, Buxheti i Familjeve, Shëndetësia, Statistikat e Krimeve, Arsimi dhe Njohuritë, Kultura, Tregu i Punës, Çmimet, Llogaritë Kombëtare, Regjistri i Ndërmarrjeve, Tregtia e Jashtme, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikacionit, Mjedisi, Peshkimi, Biodiversitet, Bujqësia – Pyjet, Transporti, Turizmi.



Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2020

"Burrat dhe Gratë në Shqipëri" është një publikim me periodicitet vjetor, i cili paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së barazisë gjinore. Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqesë të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke synuar që statistikën jo vetëm të mblidhen, analizohen dhe prezantohen sipas gjinisë, por dhe të reflektojnë problematikën e shoqërisë për monitorimin e politikave ndër-sektoriale mbi arritjen e barazisë gjinore.



Tregtia e Jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare.

INSTAT

Tregu i Punës, 2019



Statistikat e tregut të punës në Shqipëri bazohen në dy burime kryesore, anketat dhe të dhënat administrative. Anketa e Forcave të Punës (AFP) mbledh informacion cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të gjithë individët 15 vjeç e lart në Shqipëri.




Sustainable Development Goals – SDG

Zhvillimi i qëndrueshëm ka qenë në qendër të politikës evropiane për një kohë të gjatë, të vendosur në Traktatet Evropiane. Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015, i japin një shtysë të re përpjekjeve globale për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Ndërmarrjet e Huaja dhe të Përbashkëta, 2017-2019

Ndërmarrjet e Huaja në
Shqipëri 2017-2019

INSTAT



Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, doli në publikimin e veçantë për treguesit kryesorë të ndërmarrjeve me pronësi të huaj dhe të përbashkët që operojnë në Shqipëri, i cili i referohet periudhës 2017-2019. Statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja), synojnë të monitorojnë situatën, strukturën, intensitetin e tregtisë dhe performancën e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna (ASAP) 2018

INSTAT

ANKETA E STRUKTURËS
SË TË ARDHURAVE NGA PUNA,
STRUCTURE OF SALARIES SURVEY
2018



Ky botim përmban të dhëna nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna për vitin 2018 (SES 2018), e cila është realizuar nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë. Publikimi përmban të dhëna të strukturuar të karakteristikave kryesore të të punësuarve (gjinia, moshë, niveli i arritjeve, profesioni etj.) dhe ndërmarrjeve (aktiviteti ekonomik, madhësia etj.).

Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020

Indeksi i Barazisë Gjinore
për Republikën e Shqipërisë 2020



Raporti i Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale dhe Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, brenda kuadrit të Instrumentit të Asistencës para Anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Evropian, financuar nga Bashkimi Evropian. Raporti i Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë u shkrua me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Expertise France.

Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, 2016-2018

Treguesit e Mirëqenies
së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe
të Rinjve në Shqipëri

Të dhëna mbi periudhën kohore
2016-2018



Ky botim përbën risi, pasi përmbledh në një material të vetëm 83 tregues me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri. Pjesa më e madhe e treguesve janë përpunuar dhe raportuar për herë të parë përmes këtij botimi. Për formulimin e treguesve janë marrë për referencë botimet ndërkombëtare të fushës. Burimi i të dhënave është një kombinim i raportimeve administrative të institucioneve shtetërore, dhe anketave të kryera nga INSTAT.


INSTAT
Instituti i Statistikave të Shqipërisë

unicef
for every child

Kërkesat e përdoruesve


INSTAT regjistron çdo kërkesë të përdoruesve për informacion statistikor në Databazën e përdoruesve dhe nëpërmjet saj INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, nga krijimi në vitin 2009, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme, ku në vitin 2020 numri i kërkesave të përdoruesve është 861 kërkesa, nga 506 që ishin në vitin 2016.

Figura 6: Numri i kërkesave të përdoruesve 2016 – 2020



Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve, në vitin 2020 është ulur, me 6,8%, duke arritur shifrën 861 kërkesa, nga 918 kërkesa që ishin në vitin 2019. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave të çmimeve me 35,9%, pasuar nga statistikat sociale për popullsinë me 10,5%, si dhe statistikat e konsumit të familjeve me 8,8%, etj.

Figura 7: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikor



Numrin më të madh të kërkesave të plotësuara në vitin 2020 e zënë statistikat e çmimeve me 309 kërkesa, pasuar nga statistikat sociale për popullsinë me 90, si dhe statistikat e konsumit të familjeve me 76 kërkesa, etj. Një pasqyrë më e hollësishme paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave 2019	Numri i kërkesave 2020	Ndryshimi në përqindje 2019 - 2020	Përqindja ndaj totalit 2020
Çmimet	372	309	-16,9	35,9
Bujqësia dhe Blegtoria	14	23	64,3	2,7
Tregtia e jashme	68	59	-13,2	6,2
ASN	14	23	64,3	2,7
Ndërmarrjet	46	38	-17,4	4,4
Llogaritë kombëtare	30	46	53,3	5,5
Popullsia/lindjet-vdekjet/martesa/divorcet/emigracioni	110	90	-18,2	10,5
Ndërtimi	5	3	-40	0,3
Shkaqet e vdekjeve /shendetesia	19	47	147,4	5,5
Punësimi/papunesia/pagat	54	57	5,5	6,6
Turizmi/transporti/aksidentet	58	43	-25,9	5
Konsumi i familjeve /niveli jeteses / shpenzimet e familjes	74	76	2,7	8,8
Të tjera/të ndryshme/Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore/Pyetësor të ndryshëm	54	47	-13	5,5
Totali	918	861	Rënie me 57 kërkesa	100

Rrjeti Social Facebook


Gjatë vitit 2020, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.899 nga 5.705 në 2019, duke pësuar një rritje prej 3,4%. Numri më i madh i pëlqimeve u arrit gjatë muajit Dhjetor 2020.

Figura 8: Numri total i pëlqimeve, 2020



Nga numri total i pëlqimeve, 57% janë femra dhe 42% janë meshkuj. Grup-mosha më aktive në faqen e INSTAT është 25-34 vjeç, nga të cilët 31% janë femra dhe 24% janë meshkuj.

Figura 9: Numri total i pëlqimeve, sipas gjinisë dhe grup-moshave



Postimet:

1- 100 VJET PARLAMENTARIZËM SHQIPTAR 1920-2020 (Reach 6,111)

56 Like 4 koment 12 shares

<https://www.facebook.com/590804097669673/photos/a.601797059903710/2610450492371680/>

2- Studentë të diplomuar në arsimin e lartë (Reach 2,057)

31 Like 4 share

<https://www.facebook.com/590804097669673/photos/a.601797059903710/2707659282650800/>

3-INSTAT publikon numrin e katërt të revistës “KËRKIMI–Revista e Statistikave dhe Analizave Social-Ekonomike” (Reach 2,749)

58 Like 1 koment 8 share

<https://www.facebook.com/590804097669673/photos/a.601797059903710/2908426209240772/>

4- Statistikat e Transportit (Reach 3,783)

36 Like 1 koment 12 share

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3156469014436489&id=590804097669673

5- Blegtoria (Reach 6,982)

45 Like 2 koment 15 share

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3226738760742847&id=590804097669673

6- 20 Tetor 2020 është Dita Botërore e Statistikave! (Reach 4,275)

65 Like 25 Share

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3300393610044028&id=590804097669673

Numri total i postimeve nga data 1 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2020 është 59 nga 95 në vitin 2019 duke pësuar ulje për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19. Postimet në faqe janë të bazuara në kalendarin e eventeve të facebook (duke respektuar kalendarin e publikimeve të INSTAT), i cili përmban datat e daljes së publikimeve dhe eventeve të tjera të rëndësishme.

Në rrjetin social Instagram gjatë vitit 2020 janë 48 Infografike.

Mbulimi mediatik

Gjatë muajve Janar-Dhjetor 2020, përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 2.500 herë (gjatë vitit 2019 numri i përmendjeve ishte 2.870 herë) në përmbajtjen e 1.321 artikujve të botuar në shtypin shqiptar, ndërkohë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 59 përmendje. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Dhjetor dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në gazetën “Standard”.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor 2020, përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur në televizionet më të ndjekura në Shqipëri. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Qershor dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në “TV Scan”.

Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 16.512 herë në përmbajtjen e 8.160 artikujve (në 2019 ishte 7,516). Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Nëntor dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në portalin “Monitor.al”. Gjatë vitit 2020, përmendja dhe citimi i INSTAT në web-portalet e monitoruara është vërejtur 19.756, duke i renditur si më poshtë:

Tabela 8: Frekuenca krahasimore e përmendjes dhe citimeve të institucioneve shtetërore

Nr.	Institucionet	PRINT AL	TV AL	WEB AL	Grand Total
1	SPAK	20,061	870	168,152	189,083
2	Gjykata Kushtetuese	11,874	574	73,314	85,762
3	Kuvendi i Shqiperise	10,401	428	47,959	58,788
4	QSUT	2,103	460	28,547	31,110
5	INSTAT	2,500	744	16,512	19,756
6	KLSH	3,970	122	13,428	17,520
7	Banka e Shqiperise	2,879	1,472	10,519	14,870
8	OSHEE	961	429	11,769	13,159
9	BashkiaTiranes	961	198	11,433	12,612
10	Ministria e Mbrojtjes	1,024	78	9,635	10,737
11	Ministria Europes dhe Puneve te Jashtme	666	25	9,138	9,829
12	Drejtoria e Tatimeve	1,507	294	7,910	9,711
13	Ministria e Shendetesise	1,605	115	7,620	9,340
14	MFE	1,577	349	7,212	9,138
15	Ministria e Financave dhe Ekonomise	1,421	327	7,348	9,096
16	Avokati i Popullit	527	48	3,956	4,531
17	KESH	456	147	3,838	4,441
18	Ministria e Bujqesisë dhe Zhvillimit Rural	547	38	3,170	3,755
19	AKEP	389	96	3,114	3,599
20	Keshilli i Ministrave	244	15	3,074	3,333
21	OST	288	46	2,209	2,543
22	Posta Shqiptare	255	75	2,204	2,534
23	ASHK	608	8	1,708	2,324
24	AKU	156	36	1,852	2,044
25	AZHBR	148	41	1,734	1,923
26	FSHZH	419	15	1,284	1,718
27	ALUIZNI	163	3	1,215	1,381
28	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit	135	115	1,124	1,374
29	AMF	101	17	302	420
30	100Fshatrat	21	2	188	211
31	ILDKPKI	65		43	108
32	SHSHB	24	3	62	89
	Grand Total	68,076	7,190	461,573	536,839

Tabela 9: Parametra të artikujve ku përmendet INSTAT sipas gazetave dhe televizioneve të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020

Media	Përmendje	Artikuj	Sipërfaqe publikimi
Albanian Daily News	261	166	34,540
Dita	117	52	24,819
Fjala	49	24	11,171
Gazeta Liberale	111	69	23,481
Gazeta Mapo	144	83	39,655
Gazeta Nacional	1	1	665
Gazeta Shqiptare	138	73	25,004
Koha Jone	61	35	9,712
Panorama	60	41	15,875
Revista Monitor	367	174	91,076
Sot	238	110	14,691
Standard	457	212	81,057
Telegraf	351	192	70,340
Tema	96	60	20,097
Tirana Times	49	29	7,282
Grand Total	2,500	1,321	469,465

Tabela 10: Shpërndarja kronologjike e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020

Media	Jan 2020	Feb 2020	Mar 2020	Apr 2020	May 2020	Jun 2020	Jul 2020	Aug 2020	Sep 2020	Oct 2020	Nov 2020	Dec 2020	Grand Total
Albanian Daily News	25	16	22	11	23	22	16	21	31	20	26	28	261
Dita	8	28			7	4	6	10	13	20	8	13	117
Fjala					1	9	8	6	4	4	5	12	49
Gazeta Liberale	12	5		2	11	10	9	2	22	13	12	13	111
Gazeta Mapo	14	5	3		19	8	3	18	27	11	15	21	144
Gazeta Nacional			1										1
Gazeta Shqiptare	11	13	6	8	28	17	12	7	1	5	16	14	138
Koha Jone	6	5		8	8	6	1	13	3	8	2	1	61
Panorama	1	4		4	9	5	4	9	7	6	4	7	60
Revista Monitor	18	34	28	14	31	38	17	18	37	26	63	43	367
Sot	13	10	17	1	31	20	13	48	28	15	23	19	238
Standard	79	31	12		38	42	30	4	56	48	56	61	457
Telegraf	28	30	3	5	35	31	9	35	49	43	29	54	351
Tema	15	5			10	5	4	13	9	7	18	10	96
Tirana Times	11	32	5						1				49
Grand Total	241	218	97	53	251	217	132	204	287	227	277	296	2,500

Tabela 11: Shpërndarja sipas rubrikave e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020

Media	Aktualitet - Current	Ekonomi - Economy	Kronikë - Chronicle	Kulturë - Culture	Miscellaneous	Ndërkombëtare	Politikë - Politics	Sociale - Social	Grand Total
Albanian Daily News	190		2	5			20	44	261
Dita	84	2	1				13	17	117
Fjala	25						5	19	49
Gazeta Liberale	4	59		2	6	1	21	18	111
Gazeta Mapo	1	42	6		6		29	60	144
GAZETA NACIONAL			1						1
Gazeta Shqiptare	81			1	4		18	34	138
Koha Jone	6	1	8				26	20	61
Panorama	7	3					16	34	60
Revista Monitor	339				2		26	367	
Sot	142	1	16	2	1		32	44	238
Standard	171			22			66	198	457
Telegraf	129	6		9			44	163	351
Tema	27			4			24	41	96
Tirana Times	40			1			1	7	49
Grand Total	5	1,342	19	31	59	4	315	725	2,500

Tabela 12: Parametra të artikujve ku përmendet INSTAT sipas gazetave dhe televizioneve të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020

Media	Përmendje	Artikuj	Sipërfaqe publikimi
Albanian Daily News	261	166	34,540
Dita	117	52	24,819
Fjala	49	24	11,171
Gazeta Liberale	111	69	23,481
Gazeta Mapo	144	83	39,655
Gazeta Nacional	1	1	665
Gazeta Shqiptare	138	73	25,004
Koha Jone	61	35	9,712
Panorama	60	41	15,875
Revista Monitor	367	174	91,076
Sot	238	110	14,691
Standard	457	212	81,057
Telegraf	351	192	70,340
Tema	96	60	20,097
Tirana Times	49	29	7,282
Grand Total	2,500	1,321	469,465

Tabela 13: Shpërndarja kronologjike e përmendjeve dhe citimeve të INSTAT, sipas TV-ve për periudhën Janar-Dhjetor 2020

Media	Jan 2020	Feb 2020	Mar 2020	Apr 2020	May 2020	Jun 2020	Jul 2020	Aug 2020	Sep 2020	Oct 2020	Nov 2020	Dec 2020	Grand Total
ABC News	2	1	3	3	6	10		7	4		3	2	41
Fax News				1									1
News 24	5	1				6		3	1		1	1	18
Ora News	2	9	9	8	6	10	6	4	6	3	2	4	69
Top Channel	7	3	1	4	1			3	6	4	4	9	42
Top News						8		6	9				23
TV A2CNN				4	6	4	3	3	7	4	3	11	45
TV Euronews								4					7
TV Klan	2	6	5	4	6	10	2	8	5	6	1	6	61
TV Report		5	5	8	6	6		3	5		2	7	47
TV Scan	21	21	36	13	26	82	30	16	27	18	24	22	336
TV Syri											5	3	8
TVSH	3	2	3				6	3	2		1		20
Vizion Plus	1			4		8	2	4	6	1			26
Grand Total	43	48	62	49	57	144	49	64	78	36	46	68	744

Statistikat e website të INSTAT

Me përjashtim të temave “Bujqësia dhe Peshkimi”, “Censet” dhe “Ekonomi dhe Financë”, temat kryesore të faqes së INSTAT paraqiten me rritje. Në tabelën më poshtë janë të renditura për nga numri i shikimeve dhe ndryshimi në përqindje nga 2017 në 2020.

Tabela 14: Page views sipas temave kryesore 2017, 2018, 2019 dhe 2020

Tema	Total 2017	Total 2018	Total 2019	Total 2020
Shkencë Teknologji dhe Shoqëria Dixhitale	972	5.189	7.548	8.166
Çmimet	6.202	41.263	31.879	91.016
Bujqësia dhe Peshkimi	3.418	18.800	26.622	25.849
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	2.612	13.961	16.399	16.907
Tregtia e Jashtme	3.357	17.891	22.508	46.558
Kushtet Sociale	5.105	25.463	42.049	48.659
Tregu i Punës dhe Arsimi	14.266	61.446	114.113	130.851
Censet	3.697	14.936	19.050	18.390
Mjedisi dhe Energjia	5.053	11.921	14.725	15.138
Industria Tregtia dhe Shërbimet	29.469	68.291	74.284	91.851
Ekonomi dhe Financë	73.165	79.014	83.394	72.279
Treguesit Demografikë dhe Socialë	64.233	100.697	133.713	195.443

Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Institutin e Statistikave, INSTAT. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtej e tutje AP) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

INSTAT do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së INSTAT, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.instat.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e INSTAT është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

Parime të Përgjithshme

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së INSTAT janë:

“E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: INSTAT ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e INSTAT dhe përkatësisht: Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare"; Ligji nr. 7/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar"

Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e

Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).

Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

Informacioni që bëhet publik pa kërkesë

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Instituti i Statistikave, INSTAT vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.instat.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të INSTAT, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- INSTAT, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga INSTAT.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon, referuar linkut:

Në vijim jepet tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës, 2020. Duke filluar nga vitit 2021, Programi i ri i Transparencës do të pasqyrohet si në linkun: <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrko-t%C3%AB-dh%C3%ABna/programi-i-transparenc%C3%ABs/>

Tabela 15: Tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës së INSTAT

Kategoritë e Informacionit publik pa Kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Organigrama StrukturaDrejtuese	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/struktura-organizative/	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; document politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b		Menjëherë pas botimit nëfletore zyrtare	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/legjislacioni/	Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c	Ligji "Për të Drejtën e Informimit" -Format Kërkesë /Ankesë -Adresë Postare -Adresë email -Plotësim kërkesë pranë recepsionit -Kërkesë / ankesë info@instat.gov.al	Menjëherë pas botimit nëfletore zyrtare	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrko-t%C3%AB-dh%C3%ABna/programi-i-transparenc%C3%ABs/ /Kontaktet: Në fund të faqes zyrtare të INSTAT http://instat.gov.al/	Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve

Strategjitë e Zhvillimit

Të udhëhequr nga vizioni për modernizimin e statistikave zyrtare dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në to, INSTAT ka punuar ngushtësisht me institucionet e tjera publike dhe partnerët ndërkombëtarë për hartimin e dokumenteve strategjike si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë institucional e sektorial. Kështu, përveç Programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, janë hartuar edhe strategji të veçanta, si ajo e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, Zhvillimit të INSTAT, kryerjes së Censit të Popullsisë e Banesave, Strategjia e Komunikimit. Ndërkohë, në vitin 2021 INSTAT do t'i paraqesë Kuvendit të Shqipërisë Projekt-Programin e ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026, programi i ri do të ketë një natyrë tjetër përmbajtje, me qëllim kanalizimin e burimeve të nevojshme njerëzore, financiare por edhe informacionit statistikor drejt prodhimit të statistikave prioritare. Për më tepër, ky dokument do të hartohet si propozim edhe në kuadër të proceseve integruese dhe hapjes së negociatave, me qëllim që institucionet përgjegjëse për *acquis communautaire* të kenë informacionin e duhur statistikor për monitorimin e performancës.

Strategjia e Zhvillimit të INSTAT

Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

INSTAT, si burimi kryesor i informacionit statistikor, u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

Gjithashtu, INSTAT ndihmon edhe komunitetin ndërkombëtar të interesuar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor të sigurtë dhe të krahasueshëm.

Strategjia e zhvillimit të INSTAT 2017-2030, është hartuar duke marrë në konsideratë objektivat strategjike kombëtarë dhe sektorialë zhvillimorë për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, për të përmbushur kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve për statistika cilësore. Strategjia përmban 4 objektiva kryesorë të cilët kanë të bëjnë me zhvillimin e cilësisë statistikore, përdorimin e burimeve të

informacionit, përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të SKS si dhe zhvillimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor. INSTAT ka hartuar gjithashtu edhe një plan veprimi afatmesëm (2020-2023), i cili përmban një sërë nënobjektivash dhe aktiviteteve konkrete, përcakton përgjegjësitë e njësive strukturore të institucionit për përmbushjen e tyre, si dhe indikatorët për matjen e performancës së këtyre aktiviteteve. Aktivitetet me frekuencë vjetore përfshihen në Planin Operacional të INSTAT-it.

Në vijim paraqitet informacioni mbi veprimtarinë e INSTAT, gjatë vitit 2020 dhe synimet për vitin 2021, në funksion të përmbushjes së 4 objektivave strategjike madhorë, përkatësisht:

Objektivi 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.

Ky objektivi ndikon drejtpërdrejtë në plotësimin e pritshmërive të përdoruesve për statistika zyrtare për qëllime vendimmarrje, politikëbërje, kërkimore-shkencore apo orientuese, si dhe në besueshmërinë e publikut në cilësinë e statistikave të prodhuara.

Gjatë vitit 2020, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 162 nga të cilët 2 ishin publikime të reja, krahasuar me vitin 2019 që ishin 160 publikime. Nga realizimi i aktiviteteve statistikore janë prodhuar 3.257 tregues statistikor sipas Planit vjetor të PSZ, nga të cilët 98 të rinj, si dhe janë prodhuar 131 tregues statistikorë nga aktivitete që nuk ishin parashikuar në Planin Vjetor të PSZ.

INSTAT gjatë këtij vitit ka shtuar prezencën në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe kuptueshmërinë e aktiviteteve statistikore. Për të qenë më afër përdoruesit, në kuadër të zbatimit të strategjisë së edukimit statistikor, në faqen zyrtare të internetit të INSTAT është lançuar seksioni “Statistika në Shkollë” dhe janë publikuar 6 tema statistikore. Niveli i kënaqësisë së përdoruesve gjatë vitit 2020 u vlerësua me 3,87 pikë nga 5 që është vlera maksimale, duke pësuar një rritje me 2,6 pikë përqindje, në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu në kuadër të forcimit të SKS është ngritur Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare. Komiteti është ngritur me urdhrin e përbashkët ndërmjet INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 563 prot., datë 25.03.2020. Ky organizëm ka për qëllim forcimin e veprimtarisë koordinuese brenda SKS në funksion të harmonizimit dhe zhvillimit të proceseve të prodhimit statistikor, duke shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore. Më Dhjetor 2020, u zhvillua dhe mbledhja e tij parë, ku u prezantua dhe u diskutua plani i punës për përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Për vitin 2021 INSTAT do të fokusohet në përmbushjen e këtij objektivi nëpërmjet mbulimit më të mirë me informacion statistikor dhe në shtimin e numrit të treguesve në fusha të ndryshme statistikore si dhe në rritjen e përputhshmërisë së këtyre treguesve me BE sipas Smis+. Gjatë vitit do të vijojë puna për ndërtimin e një sistemi të modernizuar për mbajtjen dhe raportimin e të dhënave mbi aktivitetet statistikore të PSZ. Për rritjen e përdorimit dhe njohurisë mbi prodhimet statistikore synohet të rritet numri i mikrodatave të anonimizuara për përdoruesit, si dhe ruajtja e komunikimit të vazhdueshëm me përdoruesit nëpërmjet zhvillimit të takimeve, konferencave të përbashkëta dhe zhvillimit të takimeve formale dhe informale me

mediat. Po në këtë kuadër, do të vazhdojë puna për pasurimin me tema statistikore të seksionit “Statistika në Shkollë”, në faqen zyrtare të internetit të INSTAT.

Objektivi 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.

Rritja e burimeve të të dhënave administrative ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm në koherencën dhe cilësinë e aktivitetit statistikor, por edhe në reduktimin e kostove për sigurimin e këtyre të dhënave. Agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike, për ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e natyrës së punës që kanë, mbledhin të dhëna të cilat mund të përdoren edhe për qëllime statistikore zyrtare. INSTAT ka arritur të hartojë një listë të institucioneve që disponojnë të dhëna të cilat mund të jenë të vlefshme për rritjen e gamës së statistikave zyrtare. Megjithatë, një inventarizim më i mirë i këtyre seteve do të bëhet gjatë punës përgatitore të Programit të ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Ndërkohë, INSTAT ka intensifikuar marrëdhëniet me këto institucione nëpërmjet formalizimit të marrëveshjeve, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës si dhe përcaktimit të infrastrukturës teknologjike për transmetimin e të dhënave. Lidhur me përdorimin e sistemeve dhe instrumentave të duhur IT për mbledhjen e të dhënave mund të themi që gjatë këtij viti, dhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, sistemet dhe metodat IT janë përdorur gjerësisht në këto faza të prodhimit statistikor. Me anë të sistemit ISTI janë hedhur të dhënat për 20 aktivitete statistikore, ndërsa gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave është aplikuar metoda CAWI për 6 anketa statistikore dhe është përditësuar aplikacioni për një anketë, ndërsa metoda CAPI është përdorur për 5 anketa statistikore, dhe përditësuar për 24 të tillë.

Për vitin 2021, siç dhe është cilësuar më lart, INSTAT do të vazhdojë punën për inventarizimin e burimeve administrative, inventarizimin e variablave të burimeve administrative, inventarizimin e variablave të anketave statistikore dhe kombinimin e tyre. Ndërkohë, përsa i përket përdorimit të instrumentave të duhur IT për mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave do të vazhdojë të jëtë në fokus përdorimi i metodave inovative gjatë këtyre proceseve të prodhimit statistikor.

Objektivi 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Gjatë vitit 2020 INSTAT ka vijuar përpjekjet për ngritje kapacitetesh me anë të zhvillimit të trajnimeve dhe zhvillimit të një ambjenti motivues pune. Në trajnimet e parashikuara në planin vjetor janë trajnuar 59 punonjës. Ndërkohë në trajnimet ad-hoc të zhvilluara gjatë vitit janë tranuar 64 persona. Niveli i kënaqësisë së stafit të INSTAT për vitin 2020 është 3,89 nga 5 që është vlera maksimale.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet furnizuese me të dhëna administrative është burimi kryesor i cili ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë statistikore dhe gamën e statistikave zyrtare. Në këtë kuadër, INSTAT, gjatë vitit 2020, ka nënshkruar dy marrëveshje të reja mirëkuptimi, përkatësisht me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe me Avokatin e Popullit. Ndërkohë, për të garantuar cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore është ngritur Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare. Ndërsa në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me botën akademike, gjatë vitit 2020

është krijuar Grupi Akademik, me përfaqësues të INSTAT, universiteve publike dhe universiteve private. Ky Grup ka zhvilluar dhe mbledhjen e tij të parë, më 21.02.2020, ku u diskutua baza ligjore mbi të cilën është ngritur ky organizëm, mundësia e bashkëpunimit në projektet shkencore në kuadër të modernizimit të proceseve të prodhimit statistikor nëpërmjet bashkëpunimit në punën kërkimore, bashkëpunimi për përgatitjen e artikujve shkencorë të revistës “Kërkimi”, si dhe aksesit që kërkuesit shkencorë mund të kenë në të dhënat mikro të INSTAT nëpërmjet sistemit SIMONA. Gjatë vitit është publikuar numri i katërt i revistës me artikuj shkencorë “Kërkimi” dhe numri i parë i revistës me artikuj informativ “Infostat”.

Gjatë vitit 2021 do të vijohet me zhvillimin e trajnimeve për ngritje kapacitetesh. Për forcimin e bashkëpunimit me ofruesit e të dhënave administrative INSTAT ka bërë kërkesë për nënshkrimin e 8 memorandumeve të reja, përkatësisht me institucionet si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Këshilli i Qarkut Tiranë; Ministria e Drejtësisë; Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës; Hekurudha Shqipëtare; dhe Autoritetet Portuale dhe Portet në Shqipëri. Në drejtim të ngritjes profesionale dhe përmirësimit të performancës së sistemit, gjatë vitit 2021 do të vijojë forcimi i bashkëpunimit me botën akademike, si faktor i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e standardeve të prodhimit e përdorimit të statistikave zyrtare në fushën kërkimore-shkencore, në drejtim të përcaktimit të hapave konkret për arritjen e këtij qëllimi.

Objekti 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Në kuadër të automatizimit dhe standardizimit të proceseve të prodhimit statistikor dhe përpunimit të të dhënave, gjatë viti 2020 janë ndërtuar 5 aplikacione CAPI dhe përditësuar 24 të tillë, si dhe janë ndërtuar 6 aplikacione CAWI dhe është përditësuar 1 i tillë. INSTAT ka ndërtuar Sistemin e integruar të të dhënave (SIMONA), i cili mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore si dhe të stafit të INSTAT. Sistemi është pilotuar dhe është përfunduar gjithashtu është përgatitur dhe manuali i përdorimit të kërkuesve shkencorë, i cili mundëson përdorimin sa më efikas të këtij sistemi. Situatat e fundit të jashtëzakonshme si Tërmeti i 26 Nëntorit, 2019 dhe pandemia globale Covid-19, riskuan vazhdimësinë e aktiviteteve statistikore, duke shtruar nevojën e përgatitjes së planit për sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve. Gjatë vitit 2020 janë përgatitur planet e vazhdimësisë për 72 aktivitete statistikore. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, INSTAT do të vazhdojë angazhimin e tij në lidhje me modernizimin e mbledhjes së të dhënave dhe proceseve prodhuese të statistikave.

Sfidat për 2021

Për arritjen e objektivave strategjike dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi, sfidat kryesore për vitin 2021 parashikohet të jenë:

1. Sigurimi i Vazhdueshmërisë: Pandemia Covid-19 që shoqëroi vitin 2020 ka impaktuar vazhdueshmërinë e punës gjatë fazave të prodhimit statistikor. Për këtë arsye, gjatë vitit 2021, INSTAT do të fokusohet në sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore që riskohen nga kjo situatë nëpërmjet

zbatimit të planeve të vazhdimësisë së këtyre aktiviteteve dhe zgjerimit të përdorimit të metodave të reja shkencore për fazat e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave. Për treguesit që tërheqin interes më të gjerë tek përdoruesit, INSTAT planifikon veprimtari shtesë në mënyrë që të prodhohen statistika orientuese eksperimentale (edhe pse jozyrtare për shkak të metodologjive të ndryshme të aplikuara).

2. Kultura e ndryshimit dhe e zhvillimit: INSTAT do të përdorë instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion, e cila synon të arrihet nëpërmjet angazhimit të INSTAT me artikuj shkencorë cilësorë në revistën Shkencore Kërkimi, revistën informative si edhe rritjen e edukimit statistikor nëpërmjet zhvillimit të takimeve formale dhe informale me median, zhvillimit të takimeve shpjeguese e informuese me studentët si dhe pasurimit me tema statistikore të seksionit “Statistika në Shkolla”.

3. Politika dhe strategji efikase: INSTAT do të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të drejtojnë institucionin drejt arritjes së objektivave strategjike, e cila synon të arrihet nëpërmjet zbatimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve të BE-së.

4. Niveli organizativ e institucional: INSTAT do të punojë për ndërtimin e sistemeve menaxheriale adekuate, ndërveprimin vertikal dhe horizontal ndërmjet sektorëve për arritjen e qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata duke përdorur në mënyrën më të mundshme burimet që disponon institucioni, nëpërmjet prodhimit dhe monitorimit të indikatorëve që shërbejnë për matjen e Performancës.

5. Komunikimi me përdoruesit: Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të siguruara nga INSTAT. Institucioni do të punojë për t’iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, e cila synon të arrihet nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

Strategjia për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor

Në vitin 2019 është përgatitur dokumenti i Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor 2020-2030. Ky dokument është ndërtuar duke u bazuar në 6 aksione madhore, nga ndërmarrja e të cilëve synohet zhvillimi i mëtejshëm i Sistemit Kombëtar Statistikor:

- Vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor
- Vlerësimi i institucioneve statistika-prodhues
- Vlerësimi i institucioneve që janë ofrues të të dhënave administrative për qëllime statistikore
- Zbatimi i Kuadrit Strategjik të propozuar për SZHSKS
- Menaxhimi i SZHSKS-së
- Menaxhimi i Riskut

Në rezolutën e Kuvendit për vitin 2020, në pikën 7 të saj, rekomandohet harmonizimi i Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me formatin e strategjive të tjera kombëtare dhe sektoriale për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar, IPSIS, përfshirë edhe hartimin e planit strategjik për përafrimin me acquis në fushën e statistikave, duke marrë në konsideratë edhe prioritetet e vendosura nga BE-ja në procesin e çeljes së negociatave me Shqipërinë. Për zbatimin e këtij rekomandimi INSTAT ka hartuar një kalendar pune, ku përfshihet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i Njesisë së Zbatimit, Monitorimit dhe Raportimit (IMRT) që do të ndjekë harmonizimin e dokumentit me sistemin IPSIS. Është draftuar dhe rishikuar kapitulli që lidhet me Kuadrin Strategjik të SZHSKS, si dhe vijon bashkëpunimi me pikat e kontaktit në kryeministri, në funksion të procesit të përshtatjes së strategjisë me sistemin IPSIS.

Materiali për përshtatje në sistemin IPSIS do të përfshihet në projektprogramin e ri të statistikave zyrtare 2022-2026, i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit. Integrimi i materialit strategjik në programin e ri mundosën formalizimin e strategjisë dhe nga ana tjetër reflekton detyrimet e subjekteve zbatuese të përfshirë për arritjen e objektivave strategjike.

Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimi Evropian

Në kuadër të procesit të Integrimit, Komisioni Evropian ka përcaktuar një grup prej 8 kapitujsh *acquis*, si kapituj themelorë (fundamental clusters) për procesim të mëtejshëm raportues e përafrues. Ndër to është përfshirë edhe Kapitulli 18 “Statistikat”, gjë që reflekton rëndësinë e aktiviteteve statistikore zyrtare të prodhuara sipas standardeve evropiane me qëllim që raportet e mëtejshme të progresit e monitorimit të bazohen në shifra sa më të sakta e profesionale.

Në Maj të vitit 2020, bazuar në Vendimin nr. 422, dt 6.5.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të Grupit Negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, INSTAT është anëtar i grupit negociator, si përgjegjës për Kapitullin 18. Në këtë kuadër, INSTAT ka koordinuar punën për zbatimin e detyrimeve si anëtar i grupit negociator dhe raporton çdo javë pranë zyrës së Kryenegociatorit për problematikat dhe rezultatet e arritura.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin Evropian”, është ngritur dhe zhvillon takimet edhe GNPIE-së për Kapitullin 18. Gjithashtu, në zbatim të planit të hapave kyç për përgatitjen e takimit bilateral, sipas detyrimeve dhe afateve, janë dorëzuar pranë MEPJ, tabelat LGA dhe IAGA si dhe është dhënë kontribut për Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2021-2023. Për këtë të fundit, INSTAT ka planifikuar përgatitjen e projektligjit për Censin e Bujqësisë si dhe disa vendime për klasifikimet statistikore.

Zbatimi i rekomandimeve të BE-së

a) Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë 2020

Progres raporti 2020, i Komisionit Evropian për Shqipërinë, theksoi se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave. Sipas raportit, roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave u forcua më tej dhe burimet e tij u përmirësuan, megjithatë, metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohen si dhe proceset statistikore të prodhimit duhet të përmirësohen. Bazuar në rekomandimet e fundit të BE-së, për vitin 2020 prioritetet e identifikuar janë si më poshtë:

- Vazhdimi i përforcimeve të burimeve të INSTAT;
- Vazhdimi i përgatitjeve për Censin e Popullsisë dhe Banesave në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së dhe standardet e Kombeve të Bashkuara;
- Përgatitja e Programit të ri të Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026
- Përgatitja e planit të veprimit dhe buxhetit të detajuar vlerësuar për Censin e Bujqësisë;
- Të zbatohet Ligjin mbi Statistikat Zyrtare dhe të vazhdojë zgjerimin e qëllimit të statistikave zyrtare në përputhje me rregulloret e BE-së.

Gjatë vitit 2020, INSTAT mori pjesë dhe kontribuoi në Nënkomitetin e 12-të të Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN, i cili u organizua online në data 11-12 Nëntor 2020. Në takim INSTAT raportoi mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve të Peer Review, mbi zbatimin e ligjit të Statistikave, ecurinë e projektligjit për Censin e Popullsisë dhe Banesave etj. Nga ana tjetër, u raportua mbi përditësimin e anketës SILC, zhvillimet më të fundit në Llogaritë Kombëtare Tremujore dhe Vjetore nën ESA 2010, statistikën e Bujqësisë si dhe planet për Censin e Bujqësisë. Gjatë takimit Komisioni vlerësoi punën e bërë nga INSTAT dhe përmirësimet e vazhdueshme, por gjithashtu u theksua nevoja për përmirësime të mëtejshme, në fushat ku nevojitet rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet e BE-së.

Gjithashtu, INSTAT kontribuoi dhe mori pjesë në Nënkomitetin Agrifish, Nënkomitetin Inovacioni, Shoqëria e informacionit dhe politikën sociale, si dhe në Nënkomitetin Tregti Industri, Dogana, Tatime, të organizuar gjatë vitit 2020.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik “Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare”, INSTAT ka vijuar me angazhimin e tij në paraqitjen e raporteve, mendimeve e studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave.

Në nivel ndërkombëtar, INSTAT ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në takimet periodike të organizuara nga Kombet e Bashkuara, si në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe ndërtim të kapaciteteve për statistikën për Axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm- HLG PCCB, ku jemi anëtarë; në Komitetin e Programit të Forumit Botëror të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara; në Komisionin për Ekonominë, etj.

Prej muajit Dhjetor 2020, Znj. Dhuli është bashkëdrejtuese së bashku me Palestinën në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe ndërtim të kapaciteteve për statistikën për Axhendën e vitit 2030, për zhvillim të qëndrueshëm- HLG PCCB.

Në kuadër të aktiviteteve të sipërpërmendura në datat 19-21 Tetor 2020, u organizua Forumi Virtual Botëror i të Dhënave të Kombeve të Bashkuara - UNWDF 2020, ku INSTAT si anëtar i Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe ndërtim të kapaciteteve për statistikën për Axhendën e vitit 2030, për zhvillim të qëndrueshëm, propozoi përfaqësimin e Shqipërisë në panelin e seancës plenare të nivelit të lartë përmbyllës, me znj. Milva Ekonomi. INSTAT ka kontribuar në përgatitjen e dokumentin final të Forumit Botëror të të Dhënave, i cili do të paraqitet në përmbyllje të Forumit. Gjithashtu, INSTAT ka dhënë kontribut në Komisionin Statistikor të Kombeve të Bashkuara që u zhvillua në New York, në periudhën Shkurt – Mars 2020.

Në kontekstin Evropian, INSTAT gjithashtu ka qënë aktiv. Në datat 22-23 Tetor 2020, u mbajt online takimi i përvitshëm i Grupit të politikave për bashkëpunimin statistikor – PGSC, organizuar nga Eurostat me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, DG Near dhe donatorë si Sida, EFTA etj.

Në këtë takim INSTAT prezantoi “Përshtatjen e INSTAT me situatën aktuale, kriza Covid-19” si dhe “Zhvillimet mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave”.

Vlen të theksohet se INSTAT ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Eurostat, organizata ndërkombëtare si UN, UNECE, EFTA, OECD, PARIS 21, si dhe institucione ndërkombëtare homologe mbi mbështetjen dhe monitorimin e aktiviteteve të ndryshme statistikore, në kuadër të zhvillimeve të reja dhe me të fundit në fushën e statistikave. Gjithashtu INSTAT bashkëpunon dhe me njësitë e Integritimit Evropian në ministritë e linjës.

Koordinimi i Projekteve

Bashkëpunimi statistikor ndërkombëtar synon krahasueshmërinë e statistikave zyrtare me standardet e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i bashkëpunimit statistikor ndërkombëtar është të forcojë Sistemin Kombëtar Statistikor duke përshtatur metodologjinë dhe praktikën me Acquis dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar i statistikave gjithashtu siguron mbështetje dhe asistencë në ndërtimin e kapaciteteve duke ndikuar në rritjen profesionale.

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Pjesa më e madhe e mbështetjes është ofruar nga asistencë e Bashkimit Evropian (BE), Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO), Banka Botërore (BB), si dhe Kombet e Bashkuara (UN). Në vijim paraqitet informacion më i detajuar në lidhje me natyrën e mbështetjes.

Projektet me financime të ndryshme, të zbatuara në INSTAT gjatë vitit 2020, janë si më poshtë:

1. Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri”

Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave, në Shqipëri” aktualisht është në fazën e zbatimit të tij. Viti i dytë i zbatimit të kontratës (Janar – Dhjetor 2020) u përqendrua kryesisht në analizat e të dhënave të pilotit si dhe gjetjet e pilotit, të cilat do të përdoren për përmirësime të mëtejshme të të gjitha proceseve dhe procedurave të aktiviteteve përgatitore të Censit, specifikisht, metodologjinë, IT dhe aktivitete të lidhura me GIS. Vlerësimet e gjetjeve të pilotit, si dhe Forcat Madhore, tërmeti i 26 Nëntorit dhe Covid-19 si dhe fakti se viti 2021 është viti i zgjedhjeve kombëtare elektorale, sollën nevojën për rishikimin e planit të aktiviteteve dhe strategjisë së Censit, si dhe shtyrjen e Censit për vitin 2022. Si rrjedhojë, aktualisht kontrata është në proces të amendimit të saj. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 u zhvillua edhe përditësimi i hartave (90% e informacionit gjeohapsinor për zonat e numërimit u përditësua), rishikimi dhe miratimi i projektligjit të Censit (miratuar më 26 nëntor 2020, nga Parlamenti dhe publikuar në Fletoren Zyrtare më 28 dhjetor 2020), si dhe finalizimi i pyetësorëve të rishikuar.

2. Kontratë Shërbimi “Mbështetje për Zbatimin e Aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, IPA 2014 NP”

Kontrata e shërbimit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave, në Shqipëri” aktualisht është në fazën e zbatimit të saj.

Gjatë vitit 2020 puna u përqëndrua kryesisht në analizat e të dhënave si dhe gjetjet e pilotit të Censit, i cili u zhvillua në periudhën Tetor - Nëntor 2019. Gjatë periudhës Prill - Qershor 2020, u pezulluan aktivitetet e kontratës së Asistencës Teknike, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Pezullimi i kontratës ndikoi drejtpërdrejt në aktivitetet e planifikuara nga njësitë teknike të Censit. Me rifillimin e aktivitetit të saj, puna e Asistencës Teknike u përqëndrua më së shumti në rishikimin dhe përpunimin e mëtejshëm të dokumenteve të strategjisë, planifikimit dhe buxhetit të Censit duke marrë në konsideratë efektin e forcave madhore (tërmeti i Nëntorit të vitit 2019 dhe Covid-19), gjetjet e Pilotit të Censit si dhe faktin se viti 2021 është viti elektorale. Disa aktivitete të reja u identifikuan dhe disa të tjera u riorganizuan në përputhje me ndryshimet në planin e aktiviteteve të Censit.

3. Programi i Bashkëpunimit Statistikor me Shumë Vende Përfutuese – IPA 2019

Në vitin 2020 nisi faza e programimit të projektit. Pas thirrjes për aplikim, sektori i projekteve koordinoi punën për përgatitjen e paketës së aplikimit. Paketa e aplikimit për Grantin, iu dërgua Eurostat më datë 06.07.2020, sipas afatit dhe modaliteteve të përcaktuara. Pas aprovimit të paketës së aplikimit, më 15.12.2020, u nënshkrua Kontrata e Grantit mes Eurostat dhe INSTAT. Projekti parashikohet të fillojë zbatimin e tij në 1 Shtator 2021.

4. Projekti IPA III 2021-2027/Faza e programimit

Në fazën e parë të programimit të IPA III, INSTAT dha kontributin e tij në përgatitjen dhe plotësimin e fishës sektoriale si pjesë e dokumentit Strategjik Sektorial për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Në këtë fazë u identifikuan nevojat e Institucionit për tu mbështetur nga IPA III, përshkrimi i lidhjes së tyre me nevojat kombëtare, rajonale dhe globale. Stafi i INSTAT (pjesë e Grupit të punës) dha kontributin e tij në përgatitjen e aneksit statistikor për çdo sektor si më poshtë:

1. Për fushën “Arsimi, punësimi, mbrojtja sociale & politikat e përfshirjes, dhe shëndeti”;
2. Për fushën “Konkurrueshmëria dhe inovacioni” ;
3. Për fushën “Transporti”;
4. Për fushën “Drejtësia”;

Faza e dytë e programimit konsiston në përgatitjen e propozimeve të politikave prioritare/hartimin e fishave të projekteve për sektorin. Në këtë fazë INSTAT dha kontributin e tij, në plotësimin e fishave të projekteve për dy fushat statistikore të identifikuar në fazën e parë si nevoja prioritare për sistemin statistikor, përkatësisht Llogaritë Kombëtare si dhe statistikat e Bujqësisë. Gjithashtu matricat e “Intervention Logic” për të dyja fushat statistikore prioritare u përgatitën dhe dërguan në Kryeministri.

5. Programi IPA Shumë-përfitues IPA 2017

Mbështetja nga programi IPA shumë-përfitues i bashkëpunimit statistikor sigurohet nëpërmjet asistencës teknike specifike dhe ekspertizë për projektet pilote të ndryshme me qëllim përmirësimin e grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave cilësore. Gjatë vitit 2020 janë nënshkruar kontratat e shërbimit për 20 projekte statistikore si më poshtë:

Statistikat financiare të qeverisë dhe të deficit të tejkaluar; Llogaritë kombëtare – Metodologjia; Programi i transmetimit, llogaritë kombëtare vjetore, llogaritë kombëtare tremujore dhe raportimi i cilësisë; Llogaritë rajonale; Llogaritë sektoriale; Tabelat burime, përdorime dhe input-output; Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit dhe indeksi i çmimit të banesave; Statistikat e çmimeve – Matja e fuqisë blerëse; Regjistrat e ndërmarrjeve; Statistikat afatshkurtra: përgatitja për kuadrin rregullator për integrimin e statistikave të ndërmarrjeve; Statistikat strukturore të ndërmarrjeve dhe statistikave të demografisë së ndërmarrjeve; Statistikat e Kërkim-Zhvillimit dhe statistikave të fondeve të qeverisë të alokuara për Kërkim-Zhvillimin; Anketa e forcave të punës; Zbatimi i anketës evropiane për nivelin e jetesës; Anketa evropiane e shëndetit; Statistikat e bujqësisë; Llogaritë mjedisore; Menaxhimi i cilësisë; Zbatimi i standardeve për metadat dhe shkëmbimin e të dhënave; Statistikat e disbalancës makroekonomike.

6. Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SMEI).

Projekti “Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” financuar nga IPA II nën Programin Interreg V-B Balkan Mediterranean përfundoi më datë 31.10.2020.

Gjatë vitit 2020, pavarësisht vonësive të shkaktuara nga Covid-19, aktivitetet u realizuan. Më 09.01.2020, u aprovua modifikimi i katërt i projektit i cili konsiston në kalimin e disa aktiviteteve nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal/RDA Korça (Partner i Projektit) tek INSTAT.

Për sa më lartë, gjatë vitit 2020, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme të parashikuara, për arritjen e objektivave të projektit:

- Në vijim të plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit (SAT) nga bizneset, gjatë gjashtëmuajt të parë të 2020, INSTAT ka kontraktuar Kompaninë IDRA Research and Consulting, e cila në kuadër të WP4 ka përgatitur raportet si më poshtë:
 1. Raportin mbi të dhënat e krahasuara në nivel kombëtar mbi NVM-të në Shqipëri
 2. Raport mbi të dhënat e krahasuara nga rezultatet e SAT dhe rezultatet e anketës
 3. Raport mbi manualin e inovatorit të suksesshëm
 4. Raport mbi metodologjinë e zgjedhjes së kampionit të NVM-ve
 5. Plani i veprimit të Inovacionit
 6. Raporti i Vlerësimit të Situatës (Benchmark report):
 - Më datë 16 tetor 2020 u organizua takimi përfundimtar i projektit në Bullgari, në të cilin morën pjesë menaxheri i projektit dhe ai financiar;
 - Gjatë kësaj periudhe, raporti i 6-të, 7-të dhe i 8-të financiar janë përgatitur dhe dërguar në CFCU për certifikim;

- Janë kryer dy procedura prokurimi, njëra për kontraktimin e kompanisë së ekspertizës, përgjegjëse për përgatitjen e raporteve dhe tjetra për blerjen e materialeve zyre/kancelarie.

Projekti u finalizua me sukses duke realizuar 90% të aktiviteteve të projektit të planifikuara, 94% të buxhetit total të paguar, dhe 91,8% të buxhetit të verifikuar.

7. Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale në Statistika Faza e 5-të, Sida

Projekti është në fazën e zbatimit. Janë kryer trajnime të ndryshme sipas fushave të përfitimit, si Menaxhimi, Metodologjia dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Janë hartuar edhe modulet përkatëse të trajnimit për çdo komponent përveç komponentit të TI - së i cili nuk është parashikuar të ketë. Është krijuar sistemi i monitorimit për Burimet Njerëzore. Është zhvilluar INTRANETI (faqja e brendshme e institucionit ku shfaqen të gjitha risitë dhe zhvillimet e sektorëve të institucionit), i cili përditësohet në vazhdimësi nga punonjësit e Institucionit. Janë organizuar trajnime si për stafin e ri të INSTAT si dhe për institucionet e tjera mbi të dhënat bazë statistikore. Është në zhvillim web service për marrjen e të dhënave administrative me agjensitë e tjera statistikore qeveritare. Në zhvillim, gjithashtu, është dhe programi i planifikimit të planit statistikor 5 vjeçar. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, projekti është shtyrë me një vit.

8. Sida - Projekti i Bashkëpunimit Rajonal në Evropën Juglindore” Faza e IV

Projekti është në fazë zbatimi. Gjatë vitit 2020 janë realizuar disa aktivitete të cilat lidhen me komponentët e sipërpërmendur. Janë kryer trajnime të ndryshme sipas fushave të përfitimit, si Metodologjia e anketave dhe të Dhënat Administrative, si dhe është mbajtur Shkolla Verore.

Projekti Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare (SALSTAT)

Ecuria e projektit ka qenë e kënaqshme duke marrë në konsideratë situatën e krijuar nga Covid-19. Pothuajse janë realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara për vitin 2020, si më poshtë:

1. Workshop me ekspertët për rregjistrin e ndërtesave dhe banesave;
2. Organizimi i një vizite studimore FSO, Statistikat e Austrisë dhe INSTAT në lidhje me aktivitetin
“Zhvillimi i konceptit për rregjistrin e ndërtesave dhe banesave;
Trajnim për stafin e INSTAT –R-Language;
3. Përmbyllje e misionit të Statistikave të Migrimit;
4. Prokurimi për pajisjet kompjuterike për zyrat rajonale për të plotësuar detyrat dhe bashkëpunimin e zyrave me njëra tjetrën dhe me zyrën qendrore të INSTAT;
5. Publikimi i parë dhe i dytë i Newsletter për projektin Salstat;
6. Fillimi i procedurës për pajisjen e zyrave rajonale me mobilje si tavolina, karrige, dollape etj. Ky proces ka filluar në muajin Prill 2020 por për shkak të situatës së rënduar të Covid-19 prokurimi është anuluar për të vazhduar sërish gjatë vitit 2021;
7. Takimi i Grupit Këshillues i projektit PAG;
8. Hartimi i pyetësorit dhe platformës online për mbetjet urbane (Household Waste Statistics);

9. Trajnim online me Bashkitë dhe Zyrat Rajonale në lidhje me mbetjet urbane;
10. Komunikim online me personat përgjegjës të kapitujve të Vjetarit Statistikor Rajonal 2020 dhe publikimi i tij;
11. Trajnimet me stafet e Bashkive të vendit në lidhje me “Njohuritë bazë statistikore”;
12. Takimi i Bordit Drejtues (Steering Committee) i “Bashki të Forta” në lidhje me aprovimin e aktiviteteve të projektit.

Veprimtaria e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij, si dhe t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT udhëzime e standarde, të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”.

Bordi Drejtues përbëhet nga nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun si dhe në përmbushje të rekomandimeve të *Peer Review*, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare internetit të INSTAT-it.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2020, Bordi Drejtues ka zhvilluar një mbledhje me datë 20.02.2020 në të cilën është miratuar Plani Vjetor i Rekrutimeve dhe Plani Vjetor i Trajnimeve. Gjithashtu, në këtë mbledhje është diskutuar formati excel i Planit Operacional Vjetor 2020 si dhe struktura për hartimin e materialit shkrimor. Është shqyrtuar lista e Indikatorëve të Performancës në kuadër të Raportit Vjetor 2020, ku është shtuar një indikator i ri lidhur me numrin e vlerësimeve statistikore të kryera, si dhe është diskutuar Raporti i Buxhetit.

Gjatë katërmujorit të dytë, janë zhvilluar dy mbledhje të Bordit (përkatesisht në datat 21.05.2020 dhe 07.07.2020). Në këto mbledhje është miratuar Plani i Veprimit 2020-2023 për zbatimin e Strategjisë së INSTAT, ku në funksion të matjes së performancës së aktiviteteve është shtuar dhe kategoria e produkteve të pritshme nga këto aksione. Gjithashtu në këtë mbledhje është miratuar Plani i Vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore, si dhe është diskutuar Rregullorja e Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave.

Në katërmujorin e tretë të vitit, janë zhvilluar tre mbledhje (përkatesisht në datat 18.09.2020, 18.11.2020 dhe 21.12.2020). Në këto mbledhje Bordi ka miratuar Rregulloret e Drejtorive të INSTAT. Gjithashtu është diskutuar Rezoluta e Rekomandimeve të Kuvendit për vitin 2020, për zbatimin e së cilës janë përcaktuar aktivitetet që do të ndërmerren, afatet përkatese dhe personat përgjegjës për ndjekjen e tyre. Po ashtu gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar dhe vendet vakante në bazë të rishikimit të Planit Vjetor të Rekrutimeve. Në mbledhjen e datës 18.11.2020 Bordi i Drejtorëve ka zgjedhur Zëvendëskryetarin e ri të Bordit. Gjithashtu në këtë mbledhje është diskutuar dhe miratuar Plani Vjetor i Programit të Statistikave Zyrtare 2021. Ndërsa në mbledhjen e datës 21.12.2020 është diskutuar dhe miratuar Plani Operacional 2021 i INSTAT dhe zbatimi i versionit 5.1 i GSBPM.

Veprimtaria e Këshillit të Statistikave

Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se Programi Statistikave Zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit e statistikave zyrtare, botën akademike, shoqërinë civile, sipërmarrësit privatë, organet e vetëqeverisjes vendore dhe median.

Emërimi i anëtarëve bëhet me vendim të Kuvendit. Këshilli i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe VKM-në nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

Këshilli i Statistikave mbledhet të paktën tri herë në një vit kalendarik. Kuorumi përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të Këshillit. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 3 mbledhje të Këshillit, përkatësisht në datat 11.05.2020, 13.07.2020 dhe 05.11.2020.

Në mbledhjen e parë të datës 11.05.2020, Këshilli i Statistikave shqyrtoi Raportin Vjetor 2019 të INSTAT, ku u prezantuan dhe u diskutuan arritjet kryesore të INSTAT, indikatorët e performancës për vitin 2019 si dhe sfidat për vitin 2020. Në kontekstin e situatës së shkaktuar nga Covid-19, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT prezantoi dhe një plan konkret të masave që INSTAT ka ndërmarrë gjatë kësaj periudhe për sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve. Këto masa konsistojnë në: Hapjen e një seksioni të ri në faqen zyrtare të internetit të INSTAT dedikuar Covid-19; Përshtatjet metodologjike; Aktivitete eksperimentale lidhur me Covid-19. Gjithashtu në këtë mbledhje është diskutuar dhe struktura e raportit 4-mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, ku është sugjeruar shtimi i disa indikatorëve sasiore në funksion të matjes së performancës.

Mbledhja e dytë e Këshillit të Statistikave është zhvilluar më datë 13.07.2020 dhe pikë kryesore diskutimi në këtë mbledhje ishte Raporti i monitorimit të zbatimit të PSZ, Janar-Prill, 2020. Në bazë të rekomandimeve të lëna nga Këshilli në mbledhjen paraardhëse të tij (datë 11.05.2020), raporti në strukturën e tij paraqiti kategori shtesë informacioni si: Produkti statistikor; Burimi i të Dhënave; Metoda e grumbullimit të të dhënave; Niveli i publikimit të të dhënave; Transmetimi i të dhënave në Eurostat; si dhe Niveli i përputhshmërisë së aktiviteteve me Eurostat. Gjithashtu, në këtë mbledhje u rekomandua rishikimi i Planit Vjetor të PSZ, si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19 si dhe prezantimi i Planit të Vazhdimësisë së Aktiviteteve në mbledhjen e radhës.

Në datën 05.11.2020 është zhvilluar mbledhja e fundit për vitin 2020 e Këshillit të Statistikave, në të cilën u kaluan për diskutim çështjet sipas rendit të ditës: Raporti i Monitorimit të Zbatimit të PSZ, Maj-Gusht,

2020; Projekt-Plani Vjetor 2020 i Programit të Statistikave Zyrtare; si dhe Rezoluta e Rekomandimeve të Kuvendit 2020. Sipas raportit 4-mujor të monitorimit, gjatë harkut kohor Maj-Gusht, 2020, agjencitë statistikore kanë vijuar procesin e prodhimit statistikor sipas planit vjetor të PSZ, 2020, dhe përkatësisht kanë realizuar: INSTAT - 69 aktivitete me 118 produkte statistikore; Banka e Shqipërisë - 6 aktivitete me 12 produkte statistikore; dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2 aktivitete me 2 produkte statistikore. Ndërsa në Planin e PSZ për vitin 2021 u parashikua realizimi i 135 aktiviteteve, ku sipas këtij Plani INSTAT parashikon realizimin e 123 aktiviteteve statistikore; Banka e Shqipërisë parashikon të realizojë 10 aktivitete statistikore dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2 aktivitete statistikore. Në diskutimin për rekomandimet e lëna nga Kuvendi për vitin 2020, Këshilli pranoi rekomandimin nr.1 të Rezolutës së Kuvendit që ka të bëjë me vizibilitetin e plotë të kontributit që jep Këshilli në përmbushje të detyrimeve të Ligjit të Statistikave Zyrtare, ku specifikisht kërkohet publikimi i raporteve të rekomandimeve të lëna nga ky organizëm, duke respektuar kufizimet e Legjislacionit të fushës së mbrojtjes së të dhënave konfidenciale si dhe publikimi i pjesëmarrjes dhe mënyrës së votimit të anëtarëve në çdo mbledhje.

Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave drejton aktivitetet për përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike dhe sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

Komisioni e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe akteve nënligjore që rregullojnë ngritjen, funksionimin, detyrat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

KKN kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, dhe anëtarët e komisionit përfaqësojnë institucionet sipas VKM Nr. 671, datë 07.11.2018.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave përbëhet nga 19 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit kryesorë të nomenklaturave, pjesë e sistemit kombëtar statistikor.

Komisioni mbledhet jo më pak se 3 (tre) herë në vit dhe sa herë është e nevojshme:

- Kur Komisioni thirret nga Kryetari ose, në mungesë të tij, Zëvendëskryetari
- Në raste të jashtëzakonshme, Komisioni mund të mbledhet me propozim të 2 (dy) apo më shumë anëtarëve, pas dakordësimit nga Kryetari i Komisionit.

Nomenklaturat përdoren si bazë për mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave në çdo fushë statistikore. Ato ofrojnë koncepte të standardizuara, të përdorura për të përshkruar fenomene të tilla si aktiviteti ekonomik, produktet, shpenzimet, profesioni, shëndetësia etj, si dhe shërbejnë për të matur në mënyrë të vazhdueshme këto fenomene brenda vendit dhe në të gjithë vendet dhe rajonet gjeografike. Klasifikimet ndërkombëtare vendosin standarde për klasifikimet e përdorura, të cilat shërbejnë si modele për zhvillimin e klasifikimeve statistikore përkatëse kombëtare. Nomenklaturat bëjnë të mundur krahasimin e të dhënave me rajonin, Evropën apo edhe me shtetet e tjera në mbarë botën. Ato janë mjete që përdoren nga organizatat kombëtare të statistikave, agjencitë ndërkombëtare, akademitë dhe përdoruesit e tjerë, përfshirë edhe përfaqësuesit ligjorë.

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar dy mbledhje të Komisionit, përkatësisht në datat 19.11.2020 dhe 18.12.2020.

Në datë 19.11.2020 u zhvillua mbledhja e parë e KKN-së. Diskutimet u fokusuan në agjendën e mbledhjes, e cila përmbante çështje si: Klasifikimi i produkteve sipas aktivitetit ekonomik, versioni 2.1 (CPAV 2.1); Një Prezantim mbi trajnimin e punonjësve të pushtetit lokal mbi klasifikimin e aktivitetit ekonomik, NVE Rev.2; Nomenklatura ndërkombëtare e krimeve për qëllime statistikore (ICCS); Nomenklatura e shteteve dhe e territorit për statistikat evropiane mbi tregtinë si dhe rregullorja e re e KKN-së.

Në datë 18.12.2020 u zhvillua mbledhja e dytë dhe çështjet e diskutuar ishin: Rregullorja e re e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave; Nomenklatura e shteteve dhe territoreve në tregtinë e jashtme, gjeonomenklatura (GEONOM); Diskutime mbi nomenklaturën ISCED (Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit).

Tabela 16: Nomenklaturat e miratuara me VKM

Nr	Emri i nomenklaturës	Baza ligjore kombëtare	Baza ligjore evropiane/ndërkombëtare	Përmbajtja e bazës ligjore
1	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 2	Vendim i KM nr. 320, datë 28.5.2014 "Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2)"	Rregullore e Komisionit (EC) Nr 1893/2006 e 20 Dhjetorit 2006 mbi klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 2
2	Nomenklatura e Mallrave dhe Tarifave	1. Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË1 ndryshuar me: ligjin nr.32, dt.2.04.2015	Rregullorja e Këshillit të Europës, Nr 2658/87, të datës 23 korrik mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (Rregullorja bazë)	http://www.dogana.gov.al/dokument/1179/ligj-nr-102-2014-date-3172014-i-ndryshuar
		2. VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë		http://www.dogana.gov.al/dokument/1497/dz-vkm-nr-651-date-10112017
3	Nomenklatura e produkteve	Vendim i KM Nr. 433 date 17.6.1996 "Për miratimin e zbatimit të nomenklaturës së produkteve"	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr 1232/98 datë 17 Qershor 1998, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr 3696/93 mbi klasifikimin statistikor të produkteve sipas aktiviteteve (CPA).	http://www.instat.gov.al/media/1841/nomenklatura_e_produkteve_sipas_aktiviteteve.pdf
4	Nomenklatura e Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.515, datë 20.9.2017 për "Miratimin e zbatimit të klasifikimit të produkteve të konsumit sipas qëllimit (COICOP)".	Rregullorja e Këshillit të Europës Nr.1749/1999, datë 23 Korrik 1999 "Mbiklasifikimin e konsumit individual sipas qëllimit".	http://www.instat.gov.al/media/3959/02_nomenklatura_coicop_5digit_i_plote_final_al.pdf
5	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtar i Profesioneve (LKP) është një mjet për grupimin e vendeve të punës në grupe të përcaktuara qartë sipas detyrave të ndërmarrja në punë.	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.9.2017 Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar	Rregullorja e Këshillit të Europës Nr 1022/2009, datë 29 Tetor 2009 "Mbi Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Profesioneve".	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtar i Profesioneve (LKP)

6	Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 20.3.2019 "Për Miratimin E Nomenklaturës Së Klasifikimit Të Llojeve Të Ndërtimit (KN)	Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit
7	Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit	Vendimi i KM, Nr. 137, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës së Statistikave të Transportit".	Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 1304/2007, datë 7 Nëntor 2007, amenduar me Direktivën e Këshillit Nr. 95/64, Rregulloren e Këshillit Nr. 1172/98, Rregulloret e KE Nr. 91/2003 dhe Nr. 1365/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me themelimin e NST 2007 si klasifikimin unik për mallrat e transportuara në mënyrat e caktuara të transportit. Nomenklatura Standarde e Transporte
8	Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin	Vendimi i KM, Nr. 135, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës Ndërkombëtare të Sëmundjeve ICD-10".	Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizioni i 10-të/vëllimi I Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizionimi i 10-të/vëllimi II

Baza Ligjore dhe Organigrama

Kuadri Rregullator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare

Veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it si pjesë kryesore përbërëse e tij ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 dhe Planin Vjetor 2019 për zbatimin e tij, miratuar përkatësisht me Vendimet e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 dhe nr. 40/2019. Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet edhe në normat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë sektoriale të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale etj.

Në kuadrin rregullator të sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përarrfrojë standardet statistikore të përcaktuara veçanërisht në Rregulloren (KE) nr.223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 Mars, 2009, “Mbi statistikat evropiane...”, ndryshuar me rregulloren (KE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill, 2015.

Instrumentë të tjerë rregullatorë të veprimtarisë statistikore të SKS janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të nënshkruara nga INSTAT me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative si edhe institucionet që mbështesin kryerjen e aktiviteteve.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

a) Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare. Miratimi i ligjit u cilësua nga partnerët ndërkombëtarë si hapi më i rëndësishëm në fushën e prodhimit statistikor për të garantuar cilësinë statistikore dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për këto produkte. Me pozicionimin e INSTAT-it si institucion publik i pavarur, i cili raporton drejtpërdrejt në Kuvend, është mundësuar rritja e besueshmërisë së publikut në vlefshmërinë e statistikave të prodhuara si dhe bashkëpunimi profesional ndërmjet aktorëve të tjerë të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të ligjit për statistikat zyrtare, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave dhe kanë miratuar aktet nënligjore, të cilat rregullojnë më tej funksionimin e sistemit statistikor dhe organeve të përfshira në drejtimin e tij:

- i. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”. Ky projektakt është nxjerrë në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.
- ii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Vendimi është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile.
- iii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 07.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën është organ i cili udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të cilat përpunojnë të dhëna administrative. Ky komision ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare. Harmonizimi i nomenklaturës finalizohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të këtij komisioni.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara”. Ky vendim është miratuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit për statistikën zyrtare, në vijim të rritjes së autonomisë së INSTAT-it në menaxhimin e të ardhurave që krijon gjatë shërbimeve statistikore të kryera përtej atyre të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij.
- v. Vendimi i Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave”. Për shkak të ligjit të ri për statistikën zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur. Struktura organizative e institucioneve të pavarura rregullohet me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar.
- vi. Vendimet e Kuvendit nr. 75/2019, 76/2019, 77/2019, 78/2019, 79/2019, 80/2019 dhe 81/2019, datë 04.07.2019 për lirimin ose emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Kuvendit mundësuan plotësimin e të gjitha vendeve vakante të Këshillit të Statistikave dhe funksionimin e plotë të tij. Referuar ligjit për statistikën zyrtare, anëtarët e këshillit gëzojnë mandat 5-vjeçar me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

b) Programi i Statistikave Zyrtare

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, për një hark kohor prej pesë vitesh. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilin bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare gjatë pesë viteve të ardhshme. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Programi respekton garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në legjislacionin për statistikat zyrtare, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice)² dhe parimet themelore të Kombeve të Bashkuara (Fundamental principles).

Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021 dhe është miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”.

c) Plani Vjetor për zbatimin e PSZ

Plani Vjetor për zbatimin e PSZ është dokument i cili përgatitet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përbushje të objektivave strategjike dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në PSZ.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit për statistikat zyrtare, INSTAT është përgjegjës për përgatitjen e Planit Vjetor në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme të vitit pasardhës si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Në tërësinë e tij, dokumenti paraqet aktivitetet statistikore që do të kryejnë prodhuesit e statistikave zyrtare (aktualisht janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë), sipas fushave përkatëse statistikore që mbulojnë, shoqëruar me afatet e zbatimit të tyre. Më tej, në brendësi të tij, paraqiten institucionet që janë përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuencën e transmetimit të këtij informacioni. Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i pengesave të mundshme, dokumenti përmban edhe nivelin e risqeve të pritshme.

ç) Memorandume Mirëkuptimi

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t’iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikat zyrtare, INSTAT ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me një sërë institucioneve furnizuese me të dhëna administrative. Gjatë vitit 2020 janë nënshkruar dy marrëveshje të reja mirëkuptimit përkatësisht: INSTAT

² <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

Baza Ligjore dhe Organigrama

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe INSTAT - Avokati i Popullit, si dhe janë përditësuar sipas kuadrit të ri ligjor disa marrëveshje mirëkuptimi me institucione të tjera, të cilët mbajnë të dhëna administrative. Nëpërmjet marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilin ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve, palët shprehin vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj. Marrëveshjet e nënshkruara me universitetet kanë për qëllim përfshirjen e kërkuesve shkencorë në proceset e prodhimit dhe përdorimit të statistikave zyrtare si dhe të studentëve për tu njohur me fushën statistikore si praktikantë. Për të siguruar zbatimin e duhur të marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e saj, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. Lista e memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është si vijon:

Tabela 17: Memorandume Mirëkuptimi

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi	Data e nënshkrimit
		Prodhues të statistikave zyrtare
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008
2	Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.10.2016
Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues		
3	Ministria e Punëve të Brendshme	11.11.2010
4	Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	31.03.2016
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	20.01.2017
7	Ministria e Kulturës	11.03.2015
8	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	02.06.2017
9	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	08.07.2014
10	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	11.03.2015
11	Qendra Kombëtare e Biznesit	08.05.2017
12	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	11.04.2017
13	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	11.04.2017
14	Shërbimi Social Shtetëror	06.06.2017
15	Drejtoria e Policisë së Shtetit	05.09.2017
16	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	27.09.2017
17	Ajencia e Zhvillimit të Territorit	13.10.2017
18	Ajencia Kombëtare Elektronike dhe Postare	14.12.2017
19	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	12.01.2018
20	Autoriteti Mbikqyrës Financiar	29.12.2017
21	Ajencia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor	16.09.2016
22	Instituti i Shëndetit Publik	26.04.2018
23	Ajencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	09.02.2018
24	Avokati i Popullit	03.09.2020
25	Ajencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	09.07.2020
Bota akademike / përdorues të tjerë		
26	Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Ekonomisë	02.05.2017
27	Universiteti Bujqësor i Tiranës	25.05.2017
28	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Tiranës	20.03.2018
29	Koleji Harvard	03.02.2018
30	Universiteti "Epoka"	
31	Universiteti Evropian i Tiranës	

Bazuar në aktivitetet e Planit Operacional, synohet që për vitin 2021 të nënshkruhen marrëveshje të tjera mirëkuptimi, si edhe të rishikohen ato ekzistuese, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.

Memorandumet e reja që priten të nënshkruhen në 2021 janë me institucionet siç vijon:

Burimet Njerëzore dhe Financiare

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të përmirësimit të rezultateve të kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjësve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.

Gjatë vitit 2020, në zbatim të Strategjisë së trajnimeve të INSTAT si dhe kalendarit vjetor të trajnimeve janë realizuar trajnime të vazhdueshme si brenda dhe jashtë vendit, me qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të përditësuar.

Gjithashtu, Sektori i Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2020, ka zhvilluar procedurat e rekrutimit për shërbimin civil në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” nëpërmjet sistemit online të rekrutimeve në faqen web: www.rekrutime.instat.gov.al.

Aktivitetet të realizuara për vitin 2020

Në organikën e INSTAT, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me nr. 127/2018 datë 29.12.2018, numri i punonjësve të miratuar është 236 punonjës (187 punonjës në qendër dhe 49 punonjës në zyrat rajonale).

Bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” Drejtoria e Financës dhe Projekteve ka në përgjegjësinë e saj detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Përgjegjëse për të kryer procedurat e rekrutimit referuar Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2020, Njësia përgjegjëse në INSTAT në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Ligji për Nëpunësin Civil”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij mbi proceset e rekrutimeve, është angazhuar me zhvillimin e procedurave të rekrutimeve për punonjës të strukturës, pjesë e shërbimit civil, për plotësimin e pozicioneve vakante të institucionit. Ky proces ka filluar në muajin Shkurt 2020 dhe është pezulluar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Procedurat kanë rifilluar në muajin Korrik, 2020.

Si dhe në vitet e mëparshme stafi INSTAT-it përbëhet kryesisht nga gjinia femërore. Përqindja e vendit që zënë femrat është 68% kundrejt meshkujve me 32%.

Rekrutime

Njësia Përgjegjëse në INSTAT gjatë vitit 2020 ka përfunduar procedurat e rekrutimeve sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin civil” për 35 punonjës.

Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër

Gjatë vitit 2020 janë kontraktuar 339 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qënë 745 të punësuar në pozicionet: anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

Trajnimet e stafit

Gjatë vitit 2020 janë trajnuar gjithsej 3 punonjës në trajnime afatgjata në kuadër të programeve të BE-së dhe Eurostat IPA me shumë përfitues, si dhe 79 punonjës në trajnime të tjera 3-4 ditore.

Gjithashu, gjatë vitit 2020, Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” si dhe të “Strategjisë së Trajnimeve 2018”, ka zhvilluar 4 trajnime për punonjësit e INSTAT, ku janë trajnuar 123 punonjës me platformën online, për shkak të masave të ndërmarra nga INSTAT, për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Me mbështetjen e Projektit SALSTAT (Strong Albanian Local Statistics) financuar nga Swiss Development Cooperation Office (SDC) janë kryer 3 trajnime dhe kanë marrë pjesë 136 punonjës të INSTAT dhe të Institucioneve të tjera.

Gjatë vitit 2020, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka kryer një sërë trajnimesh me tema, të cilat përfshijnë kategori të ndryshme njohurish dhe specilistësh apo drejtuesish, nga ku janë trajnuar gjithsej 47 punonjës (20 trajnime 1-3 ditore, dhe 12 punonjës-trajnim të detyrueshëm për shërbimin civil).

Figura 10: Rekrutimet nga Njësia Përgjegjëse





Figura 11: Numri i punonjësve në raportin Femra/Meshkuj:



Burimet Financiare

Aktivitetet të realizuara për vitin 2020

INSTAT është institucioni publik qendror, i pavarur. Burimet e financimit për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Për vitin 2020 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 548 milion lekë, së bashku me donatorët janë shpenzuar 627 milion lekë sipas tabelës së më poshtme:

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE

Tabela 18: Shpenzimet 2013-2020

mijë/lekë


SHPENZIMET	FAKT							
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Paga + kontribut	231,327.8	278,819.0	280,366.0	274,469.0	349,893.0	396,913.0	466,708.8	423,141.9
Mallra dhe shërbime të tjera	59,070.5	60,091.0	57,575.0	58,318.0	67,427.0	62,330.0	79,440.6	47,887.6
Totali operative	290,398.3	338,910.0	337,941.0	332,787.0	417,320.0	459,243.0	546,149.4	471,029.6
Investime	2,997.2	6,928.0	6,401.0	11,599.0	18,902.0	27,560.0	28,994.4	44,766.8
TOTALI BUXHETI	293,395.5	345,838.0	344,342.0	344,386.0	436,222.0	486,803.0	575,143.8	515,796.4
Paga + kontribut	12,941.7	14,055.0	6,518.0	6,539.0	11,526.0	9,500.0	19,134.7	32,445.1
Mallra dhe shërbime të tjera	102.9	44.0	7,954.0	10,254.0	17,980.0	19,853.0	1,993.4	25.7
Totali operative	13,044.6	14,099.0	14,472.0	16,793.0	29,506.0	29,353.0	21,128.1	32,470.8
Investime	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI nga të ardhurat	13,044.6	14,099.0	14,472.0	16,793.0	29,506.0	29,353.0	21,128.1	32,470.8
Paga + kontribut	1,146.0	527.0	869.0	3,515.0	1,313.0	2,080.0	962.3	9,425.7
Mallra dhe shërbime të tjera	11,610.0	4,949.0	4,620.0	950.0	18,453.0	21,009.0	25,219.2	18,406.8
Totali operative	12,756.0	5,476.0	5,489.0	4,466.0	19,766.0	23,089.0	26,181.5	27,832.4
Investime	328.0					2,366.0	1,920.0	21,347.5
Të ardhura jashtë limiti	13,084.0	5,476.0	5,489.0	4,466.0	19,766.0	25,455.0	28,101.5	49,180.0
Paga + kontribut	8,514.0	4,558.0	723.0	1,430.0	1,746.0	3,666.0	23,262.0	7,071.4
Mallra dhe shërbime të tjera	61,143.0	98,905.0	15,883.0	606.0	3,950.0	9,162.0	96,209.0	14,456.3
Totali operative	69,657.0	103,463.0	16,606.0	2,036.0	5,696.0	12,828.0	119,471.0	21,527.7
Investime	400.0		2,769.0		25,775.0	5,879.0	45,049.0	8,095.0
Të ardhura nga donatorë	70,057.0	103,463.0	19,375.0	2,036.0	31,471.0	18,707.0	164,520.0	29,622.7
Paga + kontribut	253,929.5	297,959.0	288,476.0	285,953.0	364,477.0	412,159.0	510,067.9	472,084.1
Mallra dhe shërbime të tjera	131,926.4	163,989.0	86,032.0	70,128.0	107,810.0	112,355.0	202,862.2	80,776.4
Totali operative	385,855.9	461,948.0	374,508.0	356,081.0	472,287.0	524,513.0	712,930.0	552,860.5
Investime	3,725.2	6,928.0	9,170.0	11,599.0	44,677.0	35,805.0	75,963.4	74,209.3
TOTALI	389,581.1	468,876.0	383,678.0	367,680.0	516,964.0	560,318.0	788,893.4	627,069.8

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE

Figura 19: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve në vitet 2013-2020 me fondet e buxhetit të shtetit paraqitet si më poshtë:

Art	SHPENZIMET	VITI 2020			
		PL Vjetor	PL I rish	Fakt 2020	REAL Vjetor %
600	Paga	616,870.0	403,170.0	390,780.4	96.9
	Zyrat Rajonale	34,056.0	30,256.0	29,992.7	99.1
	Aparati Qendror nga buxheti	551,280.0	341,380.0	332,997.0	97.5
	Aparati Qendror nga të ardhurat	31,534.0	31,534.0	27,790.7	88.1
601	Kontribute sigigurime shoqërore-shendetësore	102,996.0	67,396.0	64,806.6	96.2
	Zyrat Rajonale	5,693.0	5,093.0	5,008.8	98.3
	Aparati Qendror nga buxheti	92,040.0	57,040.0	55,143.4	96.7
	Aparati Qendror nga të ardhurat	5,263.0	5,263.0	4,654.4	88.4
602	Mallra dhe shërbime të tjera	217,560.0	80,860.0	46,667.5	57.7
	Zyrat Rajonale	5,826.0	6,075.0	3,985.5	65.6
	Aparati Qendror nga buxheti	209,734.0	72,785.0	42,656.3	58.6
	Aparati Qendror nga të ardhurat	2,000.0	2,000.0	25.7	1.3
604	Transferime korente	1,574.0	1,574.0	622.2	39.5
	Aparati Qendror nga buxheti	1,574.0	1,574.0	622.2	39.5
606	Transferime buxhetesh familjare		623.7	623.7	100.0
	SHUMA	939,000.0	553,623.7	503,500.3	90.9
	Investime Aparati Qendror	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
230	Shpenzime për rritjen e AQ te patrupëzuara buxheti				0.0
231	I Shpenzime për rritjen e AQ te patrupëzuara buxheti	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
	TOTALI	1,033,000.0	627,623.7	548,267.1	87.4

Figura 12: Shpërndarja e shpenzimeve operative



Sif shihet nga grafiku volumin kryesor të shpenzimeve në vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe ajo e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2020 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 758,623.7 mijë lekë nga 662,940 mijë lekë të akorduara në vitin 2019, ose më shumë 95,683.7 mijë lekë.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2020 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 548,267.1 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qëndror INSTAT dhe Zyrave të Statistikave në rrethe, sipas zërave.

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE

Tabela 20: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2020

mijë/lekë

VITI 2020					
Art	SHPENZIMET	PL Vjetor	PL I rish	Fakt 2020	REAL Vjetor %
600	Paga	616,870.0	403,170.0	390,780.4	96.9
	Zyrat Rajonale	34,056.0	30,256.0	29,992.7	99.1
	Aparati Qendror nga buxheti	551,280.0	341,380.0	332,997.0	97.5
	Aparati Qendror nga të ardhurat	31,534.0	31,534.0	27,790.7	88.1
601	Kontribute sig shoq-shënd	102,996.0	67,396.0	64,806.6	96.2
	Zyrat Rajonale	5,693.0	5,093.0	5,008.8	98.3
	Aparati Qendror nga buxheti	92,040.0	57,040.0	55,143.4	96.7
	Aparati Qendror nga të ardhurat	5,263.0	5,263.0	4,654.4	88.4
602	Mallra dhe shërbime të tjera	217,560.0	80,860.0	46,667.5	57.7
	Zyrat Rajonale	5,826.0	6,075.0	3,985.5	65.6
	Aparati Qendror nga buxheti	209,734.0	72,785.0	42,656.3	58.6
	Aparati Qendror nga të ardhurat	2,000.0	2,000.0	25.7	1.3
604	Transferime korente	1,574.0	1,574.0	622.2	39.5
	Aparati Qendror nga buxheti	1,574.0	1,574.0	622.2	39.5
606	Transferime buxhetesh familjare		623.7	623.7	100.0
	SHUMA	939,000.0	553,623.7	503,500.3	90.9
	Investime Aparati Qendror	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupezuara buxheti				0.0
231	I Shpenzime për rritjen e AQ të patrupezuara buxheti	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
	TOTALI	1,033,000.0	627,623.7	548,267.1	87.4

Siç shihet nga pasqyra, në artikullin 600, Paga (që zë rreth 64,2% të buxhetit) janë shpenzuar 390.780,4 mijë lekë e barabartë kjo me 96,9%, krahasuar me planin vjetor.

Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi mesatarisht i 15 vendeve vakante të strukturës organike dhe ndryshimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, proces i cili u krye nëpërmjet bisedave telefonike nga anketuesit për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

Në artikullin Sigurime shoqërore e shëndetësore janë shpenzuar 64.806,6 mijë lekë, e barabartë kjo me 96,2%, krahasuar me planin vjetor. Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të fondit të pagave.

Në zërin Mallra dhe shërbime të tjera, për vitin 2020, janë shpenzuar 46.667,5 mijë lekë, e barabartë kjo me 57,7%, krahasuar me planin vjetor. Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i procedurave të prokurimeve si dhe mos zhvillimi i trajnimeve, udhëtimeve jashtë vëndit dhe dietave të punonjësve për shkak të Pandemisë së Covid-19.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin Transferta korrente të brendshme është 1.574 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 622,2 mijë lekë, ose 39,5% e fondit.

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE

Gjatë vitit 2020 për zërin *Transferta për buxhete familjare* janë shpenzuar 623,65 mijë lekë, ose 100%.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 44.766,8 mijë lekë ose 60,5%.


Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistikore”.

Tabela 21: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistikore”

Art	SHPENZIMET	VITI 2020		Mijë /lekë	
		Plani vjetor	Plani i vjetor i rishikuar	Fakti vjetor	% e Realizimit plan/fakt vjetor
600	Paga, sigurime shoqërore e shëndetësore	719,866.0	470,566.0	455,587.0	96.8
602	Mallra dhe shërbime të tjera	219,134.0	83,057.7	47,913.3	57.7
231	Investime	94,000.0	74,000.0	44,766.8	60.5
	Totali	1,033,000.0	627,623.7	548,267.1	87.3

Për programin e *Veprimtarisë Statistikore* për vitin 2020 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 548,267 mijë lekë, ose 87,3% ndaj planit vjetor, nga *Financimi i huaj* janë shpenzuar 29,622.7 mijë lekë ose 22,6%, nga të *Ardhurat jashtë limitit* janë shpenzuar 49,180 mijë lekë, në total janë shpenzuar 627,069.8 mijë lekë.

Figura 13: Shpenzimet 2020



Siç shihet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600+601 (paga dhe sigurime), që zë rreth 83% të tij është realizuar 96,8% , në artikullin 602 Mallra dhe shërbime të tjera zë 9% te buxhetit është realizuar 57,7% dhe në artikullin 231 shpenzime për investime që zë 8% të buxhetit është realizuar 60,5% .

Përmbushja e Rekomandimeve

Zbatimi i Rekomandimeve të Peer Review

Raporti i Peer Review 2018 parashikon 24 rekomandime, të operacionalizuara në 53 aktiviteteve zbatuese-përmirësuese.

Në drejtim të zhvillimit të Forcimit të Mjedisit Institucional gjatë vitit 2020 puna është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si vijon:

- *Forcimin e bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit në kuadër të zbatimit të standardeve të rregullores së Udhëzimeve të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale.* Ky bashkëpunim ka vijuar dhe gjatë vitit 2020. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit është në proces përgatitjeje të një akti ligjor në përputhje me rregulloren e Udhëzimeve të Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. INSTAT do të dërgojë opinionet e tij mbi këtë akt. Stafi juridik i INSTAT ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit me qëllim familjarizimin me këto standarde si dhe implementimin e tyre në praktikë.
- *Ngritjen e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare.* Komiteti është ngritur me urdhrin e përbashkët ndërmjet INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 563 prot., datë 25.03.2020. Ky organizëm ka për qëllim forcimin e veprimtarisë koordinuese brenda SKS në funksion të harmonizimit dhe zhvillimit të proceseve të prodhimit statistikor. Më 22 Dhjetor, 2020, u zhvillua dhe mbledhjen e tij parë, ku u prezantua dhe u diskutua plani i punës për përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026.
- *Përgatitjen e udhëzimeve të detajuara të Cilësisë.* Udhëzimet e detajuara të cilësisë janë përgatitur nën asistencën e ekspertizës teknike në kuadër projektit statistikor 6.1 “Cilësia Statistikore”. Ky dokument është përfunduar dhe diskutuar në Komitetin e Cilësisë dhe pritet të miratohet në mbledhjen e radhës të Bordit Drejtues.

Për **zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet** gjatë vitit 2020 puna është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si vijon:

- *Pilotimin, zbatimin dhe raportimin e progresit të përdorimit të teknikave elektronike në mbledhjen e të dhënave.* Në tremujorin e parë të vitit 2020 është pilotuar Metoda CAPI për mbledhjen e të dhënave të Anketës Tremujore të Ndërmarrjeve, për 15 anketues. Progresi i përdorimit të këtyre teknikave është raportuar në Raportin Vjetor 2019 të INSTAT.

- *Pilotimin e metodës së standartizuar për prodhimin statistikor.* Është testuar moduli i inputimit për Anketën Tremujore të Ndërmarrjeve, si dhe progresi i përdorimit të kësaj qasjeje është raportuar në Raportin Vjetor 2019 të INSTAT.
- *Implementimin e hapave për harmonizimin e proceseve statistikore në drejtim të GSBPM, në bashkëpunim me NSI –të e tjera.* Në këtë drejtim, INSTAT ka vendosur linjat e bashkëpunimit me NSI-të e tjera. Planin për harmonizimin e proceseve statistikore në drejtim të GSBPM është përfunduar dhe dërguar në Eurostat.
- *Kryerjen e pilotëve për auditimin dhe vetëvlerësimin bazuar në planin e punës dhe pyetësorët përkatës.* Gjatë vitit 2020 është kryer pilotimi për auditimin dhe vetëvlerësimin për Anketën e Statistikave Strukturore. Ky pilotim është diskutuar dhe miratuar në Komitetin e Cilësisë. Planin për auditimin e cilësisë dhe vetëvlerësimin është i integruar në Planin Operacional të INSTAT.
- *Testimin e sistemit për matjen e kohës, i instaluar në INSTAT dhe dedikimi në çdo aktivitet statistikor dhe mbështetës.* Sistemi është testuar dhe gjatë vitit 2020 lidhur me kosto-efektivitetin janë testuar 22 aktivitete statistikore.


Në kuadër të **përmirësimi të komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë** gjatë vitit 2020 puna është fokusuar në realizimin e aktivitetit të mëposhtëm:

- *Ngritjen e grupit të punës me botën akademike për formalizimin e marrëdhënieve dhe administrimin e dokumentacionit të prodhuar për këtë qëllim.* Është ngritur ‘Grupi Akademik’ me përfaqësues të INSTAT dhe përfaqësues të universiteteve publike dhe private, kryesisht pedagogë të përfshirë në kërkime shkencore. Më 21 Shkurt, 2020, është zhvilluar dhe mbledhja e tij e parë, ku u diskutua baza ligjore mbi të cilën është ngritur ky organizëm, mundësia e bashkëpunimit për modernizimin e proceseve të prodhimit statistikor nëpërmjet bashkëpunimit në punën kërkimore. Gjithashtu u diskutua dhe mundësia e aksesit që kërkuesit shkencorë mund të kenë në të dhënat mikro të INSTAT nëpërmjet sistemit SIMONA.

Si përfundim, nga 24 rekomandime të lëna në “Peer review 2018”, janë përfunduar 16 prej tyre dhe 8 të tjera janë në proces realizimi. Ndërkohë, nga 53 aktivitete përmirësuese, janë realizuar 39 prej tyre, 13 të tjera janë në proces realizimi dhe 1 aktivitet është anuluar.

Më poshtë paraqitet grafiku i statusit aktual të aktiviteteve përmirësuese si dhe grafiku i realizueshmërisë së tyre.

Figura 14. Statusi aktual i aktiviteteve dhe realizueshmëria



Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit

Më 23.07.2020 u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së INSTAT për vitin 2019. Në këtë dokument vlerësohet veprimtaria e INSTAT lidhur me: realizimin e të gjithë aktiviteteve të parashikuara sipas dokumentit strategjik dhe buxhetit të Censit dhe sidomos aktivitetit më të rëndësishëm të fazës përgatitore, Pilotit të Censit; Kontributin me dy aktivitete statistikore ad-hoc për të matur impaktin e dëmeve të tërmetit pranë familjeve dhe ndërmarrjeve në zonat më të prekura; Shtimin e prezencës në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe, kuptueshmërinë e produkteve statistikore; Prodhimin e statistikave zyrtare në nivel vendor për një njohje dhe kuptim më të mirë të të dhënave në secilën bashki e komunë të vendit; Rritjen e bashkëpunimit me botën akademike përmes shkëmbimit të praktikave, bashkëpunimit për përgatitjen e artikujve shkencorë dhe sigurimin e aksesit në të dhënat mikro për qëllime shkencore; Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për integrimin evropian dhe angazhimin për furnizimin me informacionin e duhur statistikor të të gjithë kapitujve të tjerë të acquis.

Në vijim Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave të përmirësojë punën në drejtim të:

- Transparencës së veprimtarisë së Këshillit të Statistikave dhe Bordit Drejtues;
- Plotësimit të vendeve vakante te Nivelit të Lartë Drejtues;
- Përgatitjes dhe sigurimit të planit të vazhdimësisë në situatë pandemie/të jashtëzakonshme;
- Fuqizimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe të stafit në fushën IT, përmirësimit të pyetësorit dhe materialeve shoqëruese të Censit;
- Hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit për Censin e Bujqësisë 2022;
- Harmonizimit të SZHSKS me sistemin IPSIS dhe hartimit të planit strategjik për përafrimin me acquis në fushën e statistikave;

- Forcimit të Bashkëpunimit brenda SKS;
- Përafrimit gjithnjë e më shumë të pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve.


Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi, INSTAT ka hartuar një plan të plotë aktivitetesh zbatuese, shoqëruar me afatet përkatëse dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Ecuria e zbatimit të këtij plani për vitin 2020 është si vijon:

Në drejtim të përmirësimit të vizibilitetit të veprimtarisë së Këshillit të Statistikave dhe Bordit Drejtues, INSTAT do të publikojë raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga Bordi Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, si dhe të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve në çdo mbledhje dhe mënyra se si ka votuar. Përsa i përket plotësimit të pozicioneve të nivelit të Lartë Drejtues, në Tetor 2020 është proceduar me shpalljen e këtyre pozicioneve, ku si rezultat u plotësua një pozicion dhe një procedurë rezultoi pa fitues. Ndërkohë është miratuar dhe plani i rekrutimeve për vitin 2021. Në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore në situatë të jashtëzakonshme, INSTAT ka hartuar dhe miratuar një format vazhdimësie për aktivitetet statistikore dhe gjatë vitit 2020 janë plotësuar Planet e Vazhdimësisë për 72 aktivitete statistikore, shoqëruar dhe me përditësimin e regjistrit të riskut. Gjithashtu në Planin Vjetor të PSZ 2021 është përfshirë një seksion dedikuar masave që do të ndërmerren për menaxhimin e situatës së krijuar nga Covid-19. Për fuqizimin e kapaciteteve IT, INSTAT ka ndërtuar Sistemin e integruar të të dhënave (SIMONA), i cili mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore, si dhe të stafit të INSTAT. Sistemi është pilotuar dhe është përfunduar dhe manuali i përdorimit të kërkuesve shkencorë, i cili mundëson përdorimin sa më efikas të këtij sistemi. Gjithashtu, janë kryer investime në fushën e Teknologjisë së Informacionit në lidhje me përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të teknologjisë në nivel hardware dhe software, duke ruajtur ndërkohë konfidencialitetin dhe privatësinë. Gjatë vitit 2020, për ngritje kapacitetesh në stafin IT, janë zhvilluar 66 trajnime të organizuara nga INSTAT apo zyrat statistikore homologe. Për përmirësimin e pyetësorit të Censit të Popullsisë dhe Banesave janë shfrytëzuar gjetjet e Censit Pilot 2019. Gjithashtu, në kuadër të Censit është kryer përditësimi i zonave në terren të prekura nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura në vend. Në drejtim të harmonizimit të SZHSKS me sistemin IPSIS, INSTAT ka hartuar një kalendar pune, ku përfshihet ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i Njesisë së Zbatimit, Monitorimit dhe Raportimit (IMRT) që do të ndjekë harmonizimin e dokumentit me sistemin IPSIS. Është draftuar dhe rishikuar kapitulli që lidhet me Kuadrin Strategjik të SZHSKS si dhe vijon bashkëpunimi me pikat e kontaktit në kryeministri, bashkëpunim i cili do ti shërbejë procesit të përshtatjes së strategjisë me sistemin IPSIS. Në procesin e përafrimit me *acquis* në fushën e statistikave është përgatitur PKIE 2021-2023 dhe është dorëzuar pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për të siguruar cilësinë në proceset e planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore është ngritur Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, i përfaqësuar nga INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria

e Financave dhe Ekonomisë. Komiteti ka zhvilluar mbledhjen e tij të parë më 22.12.2020, ku u diskutua plani i punës për përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Në drejtim të *përafrimit gjithnjë e më shumë të pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve*, në website-in e INSTAT është lançuar seksioni “Statistika në shkolla”, i cili përditësohet vazhdimisht me të dhënat e publikuara për çdo fushë statistikore. Në këtë kuadër janë organizuar gjithashtu takime formale dhe informale me përfaqësues të medias.

Më poshtë paraqitet grafiku i aktiviteteve të kategorizuara sipas statusit të ecurisë për vitin 2020.

Figura 15: Statusi i aktiviteteve



Zbatimi i rekomandimeve të auditeve

Në vitin 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer një autidim pranë Institutit të Statistikave sipas Programit të Auditimit “*Mbi auditimin financiar të institucionit*”, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, me nr. prot 63/1, datë 21.01.2020.

Rekomandimet e lëna për INSTAT nga grupi auditues janë në total 15, nga të cilat 12 janë realizuar, 2 janë rekomandime në vazhdimësi dhe 1 rekomandim nuk lidhet me natyrën e punës së INSTAT.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, INSTAT ka marrë masat siç vijon:

- Në raportet e monitorimit është relatuar në lidhje me realizimin treguesve në raport me parashikimin e fondeve buxhetore;
- Ndryshimet e kërkuara për rakordimin dhe unifikimin e vlerave janë pasqyruar në pasqyrën financiare të viteve pasardhëse në zbatim të udhëzimit nr. 8 date 09.03.2018;
- Janë hartuar çdo muaj situacionet e të ardhurave dhe të shpenzimeve të rakorduara me degën e thesarit si dhe raporte periodike për realizimin e shpenzimeve kundrejt fondeve të akorduara;

PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE

- Në pasqyrat financiare janë regjistruar dhe ndjekur zërat e nënllogarive të granteve dhe subvensioneve dhe janë hartuar çdo muaj situacionet e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse janë rakorduar dhe unifikuar vlerat në përputhje me udhëzimin mbi përgatitjen e llogarive vjetore;
- Është përgatitur rregjistri për aktivet afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Është ngritur urdhëri nr. 76/7 prot, datë 09.06.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimit nr. 8.1 të KLSH: *“Drejtori i INSTAT, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të kësaj pasurie, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, si dhe pas saktësimit të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për vlerësimin e trojeve dhe të pronave që ky Institutucion ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. - Të aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve të INSTAT.”*;
- Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 është bërë procesi i inventarizimit, vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre. Janë hartuar relacionet përkatëse dhe raporti përmbledhës;
- Është hartuar urdhër i brendshëm Nr. 8 datë 19.01.2021 “Për fshirjen e detyrimeve të mbartura të krijuara para vitit 2008”.
- Është përgatitur kontrata e ankandit për shitjen e 4 automjeteve nr. 1217/4 datë 20.10.2020.
- Pasqyrat financiare janë shoqëruar me relacionin shpjegues;
- Drejtoria e financës ka realizuar rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit;
- Me vendimin nr. 4, të datës 18.09.2020 të Bordit Drejtues janë miratuar rregulloret e brendshme për të gjitha drejtoritë.

Kontaktet e Institucionit



INSTAT - Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon+(355) 42222411